



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 45 (827743)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 Nëntor 2021

Peleshi: "Defender 2021", histori suksesi



Shqipëria, gati të shërbejë sërish si vend pritës i stërvitjes më të madhe "Defender 23"

Shoqata e Ushtarakëve Rezervë të Republikës së Kosovës nënshkruan marrëveshjen e parë të bashkëpunimit me Shoqatën Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë. Presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës, nënkolonel Prindon Sadriu dhe presidenti i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve

Rezervë të Shqipërisë, kolonel Thoma Konduri, nënshkruan Marrëveshje të Bashkëpunimit mes dy shoqatave. Dy palët u dakorduan që të thellojnë më tej bashkëpunimin në mes tyre, me qëllim të ngritjes së gatishmërisë dhe kapaciteteve të forcave rezervë, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar...

» faqe 2

Modeli i suksesit përballë çdo sfide ka emrin Grua

Ç'do eksperiencë në jetë është një mundësi

Intervistë me major Lorena Papa, oficer Shtabi në Divizionin e Planifikimit, J-5, në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali



» faqe 6-7

Mbi 20 milion dollarë për emergjencat Peleshi takon kryebashkiakët e prefektët: Parandalimi i përmytjeve dhe menaxhimi i pasojave redukton riskun

Ministri i Mbrojtjes dhe drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile, Haki Çako, kërkuar bashkëpunimin e ngushtë të drejtuesve të pushtetit vendor për të marrë të gjitha masat për përballimin e pasojave » faqe 3



"Strong Eagle 3"

Stërvitja e përbashkët shqiptaro-britanike

Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS) i RFT me palën britanike po zhvillojnë stërvitjen e përbashkët të koduar "Strong Eagle 3". Kjo stërvitje zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me palën britanike për periudhën 25 tetor 2021 deri më 12 nëntor 2021, në rajonet Zall-Herr, Bizë dhe Kepi i Palit. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e kapaciteteve taktike të ROS në nivel SOLGT dhe integrimi i reparteve dhe nënreparteve të ROS për të arritur ndërveprueshmërinë midis Brigadës së Operacioneve Speciale...



» faqe 3

Ceremonia

Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj: Ky investim rrit dhe përmirëson aftësitë tona logjistike si një nga shtyllat kurrizore të qëndrueshmërisë tonë ushtarake

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit të depove të armatim-municionit, të rërukturuara të batalionit të Xhenios të financuara nga SHBA. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, e cila u zhvillua në ambientet e batalionit të Xhenios, ishte i ftuar nga ambasada e SHBA-së në Tiranë, edhe zv. ambasadori i SHBA-së, z. Damien Smith...

» faqe 4

Konferenca

Stoltenberg: Ndryshimi i klimës shumëfishues i krizës, e bën botën më të rrezikshme

» faqe 8



FORCA AJRORE

"Bashkëpunim me Njësinë e Trajnimit për Kontrollin e Hapësirës Ajrore, Itali (RACSA) edhe në të ardhmen"

» faqe 5

"SKËNDERBEGASIT"

Legjenda e kuqe
Panajot Pano

» faqe 10

Marrëveshje Bashkëpunimi mes dy shoqatave

Zëvendësministria Bici: Angazhimi i MM për rezervën e FA të Shqipërisë do të jetë maksimal

Shoqata e Ushtarakëve Rezervë të Republikës së Kosovës nënshkruan marrëveshjen e parë të bashkëpunimit me Shoqatën Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë

Presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës, nënkolonel Prindon Sadriu dhe presidenti i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë, kolonel Thoma Konduri, nënshkruan Marrëveshje të Bashkëpunimit mes dy shoqatave.

Dy palët u dakorduan që të thellojnë më tej bashkëpunimin në mes tyre, me qëllim të ngritjes së gatishmërisë dhe kapaciteteve të forcave rezervë, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me synimin final anëtarësimin e Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës në Konfederatën Ndërraleate të Oficerëve Rezervë (CIOR), me seli në Bruksel.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, nënkolonel Sadriu falënderoi homologun e tij për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe për kontributin e dhënë për krijimin e urave të komunikimit me CIOR.

Gjithashtu, gjatë vizitës zyrtare në Shqipëri, delegacioni i Shoqatës së Ushtarakëve Rezervë të Kosovës zhvilloi takim të ndarë me zëvendësministren e Mbrojtjes së Republikës

Shoqata e Ushtarakëve Rezervë të Republikës së Kosovës nënshkruan marrëveshjen e parë të bashkëpunimit me Shoqatën Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë



së Shqipërisë, znj. Dallëndyshe Bici.

Në këtë takim, zëvendësministria Bici, e njoftoi delegacionin nga Kosova për angazhimin dhe planet e Ministrisë së Mbrojtjes për rezervën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ajo vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm dhe vëllazëror mes dy shoqatave të oficerëve rezervë si dhe ofroi mbështetjen e saj për aktivitetet e përbashkëta dhe ato brenda CIOR-it. Në fund të takimit zëvendësministria Bici transmetoi përshëndetjet e saj për ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Armend Mehaj.

Në përfundim të vizitës, delegacioni nga Kosova zhvilloi një takim pune në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë, ku u prit ngrohtësisht nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë, Skender Durmishi, në shoqërim të atasheut tonë të Mbrojtjes, kolonel Bashkim Shillova.

VIZIT PORTUALE NË SPLIT

Anija e Forcës Detare P-134 "Butrinti" ka zhvilluar vizitë portuale në Split, Kroaci dhe Bar, Mali i Zi

Anija P-134, "Butrinti" me komandant kapitenin e rangut III-të Altin Liçaj, ka zhvilluar vizita portuale në Split, Kroaci dhe Bar, Mali i Zi. Komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiteni i rangut I-rë Sabri Gjinollari, para nisjes së anijes për vizitë, përshëndeti dhe uroi efektivin e Anijes P-134 "Butrinti", duke iu uruar udhëtim të mbarë. Komandanti i anijes P-134, "Butrinti", u prit nga komandanti i Rojës Bregdetare të Kroacisë, ku gjatë takimit u diskutua në lidhje me shkëmbimin e eksperiencave, bashkëpunimin në stërvitje dhe vizitat portuale të mëtejshme midis dy vendeve. Komandanti i Anijes P-134 "Butrinti", gjithashtu u prit dhe nga kryebashkiaku i Splitit, Z. Ivica Puljak, i cili shprehu mirëseardhjen në vizitën e tyre të parë zyrtare të anijes së Forcës Detare të Shqipërisë. Gjatë vizitës në Bar, Mali i Zi, komandanti i anijes P-134 "Butrinti" dhe shefi i Seksionit të Operacioneve dhe Stërvitjes së Flotiljes Detare, kapiteni i rangut II-të Eduart Jeminaj, kanë realizuar një vizitë në Komandën e Forcës Detare të Malit të Zi, në të cilën u pritën nga Komandanti i Forcës Detare malazeze Commander Milan Jeftovic. Më pas u pritën në një takim nga kryetari i Bashkisë Z. Dusan Raicevic, i cili shprehu mirëseardhjen dhe dëshirën për rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë midis dy vendeve. Gjatë zhvillimit të vizitës efektivi i Anijes P-134 "Butrinti", pati mundësi të njihen edhe me vlerat kulturore dhe tradicionale të Malit të Zi, në disa vende si Kotorr dhe Ulqin.



Në prag të sezonit të dimrit, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi së bashku me drejtorin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako kërkuan bashkëpunimin e ngushtë të drejtuesve të pushtetit vendor për të marrë të gjitha masat për përballimin e pasojave që mund të sjellin reshjet e shiut. Gjatë një takimi me kryebashkiakët e vendit si dhe me prefektët e 12 qarqeve, ministri i Mbrojtjes vuri në dukje faktin se tashmë Shqipëria ka hyrë në zonën e riskut të lartë, në bazë edhe të raportit vjetor të riskut botëror.

“Ne tani jemi në sezon dhe do përqendrohemi më tepër te menaxhimi i pasojave, sepse nuk është se kemi kohë sot të flasim për shkakun, për parandalimin e përmbajtjeve, por gjithsesi investimet edhe puna e përbashkët për të reduktuar riskun më afatgjatë përmes investimeve dhe punës së koordinuar duhet të jetë një paralele që duhet të na shoqërojë vazhdimisht. Sistemi i ringritur ose i rishikuar sot për sot është një Agjenci Kombëtare e Mbrojtjes Civile, e cila funksionon nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes që është autoriteti që koordinon të gjitha forcat, të gjitha institucionet që kanë një rol për të luajtur në përballimin e emergjencave”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ndërsa shprehu falënderime për punën e kryer gjatë periudhës së verës me zjarret, por edhe në rastet e përmbajtjeve, z. Peleshi vuri theksin në një koordinim më të mirë mes bashkive dhe institucioneve qendrore.

“Ajo që nuk duhet të ndodhë në të ardhmen është që një bashki e caktuar, duke menduar që sado të agravohet një emergjencë, do të vinë ata të emergjencës së Tiranës, do futet ushtria e do ta zgjidhë punën dhe të flejë gjumë. Kjo nuk ju bën mirë as juve, jo e jo, që jeni përgjegjës për të kontrolluar dhe mbrojtur komunitetet tuaja, por edhe ne pastaj na bëhet shumë e vështirë të neutralizojmë një emergjencë. Duhet të kemi një reagim të hershëm, duke vënë në funksion edhe komunitetin, i cili duhet të ndërgjegjësohet për të lajmëruar, në mënyrë që të parandalojmë sa më shpejt emergjencën. Në rast se kjo nuk ndodh, pastaj përmasa mund të jetë aq e madhe saqë edhe gjithë FA, të gjitha mjetet tona, apo të institucioneve të tjera mund të mos mjaftojnë”, - u shpreh z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes bëri të ditur se qeveria ka menduar një mbështetje financiare mbi 20 milionë dollarë për Emergjencat Civile.

“Ne kemi këtë vit rreth 2,1 miliardë pra më shumë se 20 milionë dollarë buxhet për Emergjencat Civile, e cila do të ndahet pak a shumë në mes, pra 1,1 miliardë do të thotë 11 milion dollarë do të jetë si transfer të kushtëzuar për bashkitë, 600 milion do të transferohen në buxhetet tuaja nga Ministria e Financave përmes Ministrisë së Mbrojtjes”, - sqaroi ministri Peleshi, duke shtuar se buxheti për emergjencat asnjëherë nuk është i mjaftueshëm, por këtë herë ai jep mundësitë për t'i përballuar ato më mirë.

Një risi gjithashtu, sipas ministrit Peleshi është edhe fondi prej 800 milionë lekësh për investimet në fushën e Mbrojtjes dhe parandalimit të emergjencave civile, i cili do të transferohet tek bashkitë për projekte, që do të seleksionohen nga një komitet që do të ngrihet dhe do të bëjë përzgjedhjen e propozimeve nga njësitë vendore.



Mbështetje mbi 20 milion dollarë në buxhetin e ri për emergjencat

Peleshi takon kryebashkiakët e prefektët: Parandalimi i përmbajtjeve dhe menaxhimi i pasojave redukton riskun

Ministri i Mbrojtjes dhe drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile, Haki Çako, kërkuan bashkëpunimin e ngushtë të drejtuesve të pushtetit vendor për të marrë të gjitha masat për përballimin e pasojave



“STRONG EAGLE 3”

Stërvitja e përbashkët shqiptaro-britanike

Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS) i FT me palën britanike po zhvillojnë stërvitjen e përbashkët të koduar “Strong Eagle 3”.

Kjo stërvitje zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me palën britanike për periudhën 25 tetor 2021 deri më 12 nëntor 2021, në rajonet Zall-Herr, Bizë dhe Kepi i Palit. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e kapaciteteve taktike të ROS në nivel SOLGT dhe integrimi i reparteve dhe nënreparteve të ROS për të arritur ndërveprueshmërinë midis Brigadës së Operacioneve Speciale të Mbretërisë së Bashkuar dhe Regjimentit të Operacioneve Speciale. Objektivat e stërvitjes janë njohuritë mbi procesin në vendimmarrje dhe përgatitje të urdhrave operacionale, demonstrimi i komandim kontrollit në nivel shtabi me njësitë vartëse, si dhe ndërtimi i komunikimit të sigurt me të gjitha njësitë vartëse.





Ceremonia e dorëzimit të depove të armatim-municionit

Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj: Ky investim rrit dhe përmirëson aftësitë tona logjistike si një nga shtyllat kurrizore të qëndrueshmërisë tonë ushtarake

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit të depove të armatim-municionit, të ristrukturuara të batalionit të Xhenios të financuara nga SHBA.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, e cila u zhvillua në ambientet e batalionit të Xhenios, ishte i ftuar nga ambasada e SHBA-së në Tiranë, edhe zv. ambasadori i SHBA-së, z. Damien Smith, z. Mark Veneris (EUCOM J9), si dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij përshëndetëse në këtë ceremoni të veçantë, gjeneralmajor Begaj, shprehu falënderimet dhe mirënjohje në emër të ministrit të Mbrojtjes dhe në emër të tij dhe të gjithë Forcave të Armatosura për këtë projekt të rëndësishëm, investimi i të cilit do të mundësojë rritjen dhe përmirësimin e aftësive në infrastrukturën tonë logjistike.

“Është kënaqësi të jem sot këtu me të ftuarin tonë special, nga ambasada e SHBA-së, z. Smith. Sot ne po shpalojmë një tjetër projekt të rëndësishëm të mbështetur nga partneri ynë strategjik, i cili është dhe mbetet aleati më i afërt për ne. Ky investim rrit dhe përmirëson aftësitë tona logjistike si një nga shtyllat kurrizore të qëndrueshmërisë tonë ushtarake...”, -u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Nga ana e tij, zv. ambasadori amerikan, z. Smith vlerësoi aleancën dhe miqësinë mes SHBA-së dhe Shqipërisë, duke veçuar partneritetin dhe bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes. “Tunelet e rinovuara rishtazi, së bashku me stërvitjet dhe pajisjet përfaqësojnë një aftësi tjetër të rëndësishme për Forcat tuaja të Armatosura...”, -u shpreh ndër të tjera z. Smith.

Ceremonia u përmbyll me një demonstrim të veprimeve për mënyrën e funksionimit të tyre.



KOMANDANTI I QAPN, KOLONEL ARBEN TOSKA:

Ky kurs përbën një hap tepër të rëndësishëm në karrierën e nënoficerit, ju tashmë keni vendosur gurin e parë kilometrik

Përfundon kursi i 70-të Fillestar i Nënoficerit në QAPN. Në datën 29 tetor, në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të Kursit të 70-të Fillestar të Nënoficerit, ku morën pjesë Komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve, Zv/Komandanti i QAPN si dhe Stafi instruktorëve dhe ai mbështetës.

Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i QAPN Kolonel Arben Toska u shpreh se “Ky kurs përbën një hap tepër të rëndësishëm në karrierën e nënoficerit, ai është hapi i parë i një rrugëtimi të gjatë për ju, karriera juaj sapo ka nisur, ju tashmë keni vendosur gurin e parë kilometrik. Ju jeni duke hedhur hapin e parë institucional për



t'u bërë, pjesëtarë të korpusit të nënoficerëve të Forcave të Armatosura, fuqia e dijes dhe forca më madhe e ushtarakut. Jeni ushtarët e së sotmes dhe nënoficerët e së ardhmes, që do të drejtoni efektivët si në stërvitje ashtu dhe në operacione ushtarake brenda dhe jashtë vendit”. Në përfundim të fjalës së tij Kolonel Toska, falënderoi kursantët për përkushtimin dhe disiplinën e treguar gjatë kursit, si dhe trupën pedagogjike mësimdhënëse dhe atë mbështetëse, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në transmetimin e dijeve dhe njohurive tek kursantët. Në këtë kurs morën pjesë dhe u certifikuan 62 kursantë, ku 5 prej tyre ishin personel femra.

KLSM vizitë në Shtabin e NATO-s (NATO Headquarter) në Bruksel

Në kuadër të programit mësimor me qëllim njohjen me Institucionet Ndërkombëtare të nivelit të lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, KLSM ka vizuar me vizitën në Shtabin e NATO-s (NATO Headquarter) në Bruksel. Gjatë takimit pjesëmarrësit e këtij kursi janë njohur me axhendën politike të NATO-s 2030, Sfidat Hibride dhe Siguria Energjitike si dhe Politikën e Sigurisë dhe Aleancës. Në kuadër të programit për trajnimin e Liderëve Ushtarakë dhe Civilë në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, vijoi programi mësimor me Institucionet Ndërkombëtare të NATO-s dhe BE-së në Bruksel. KLSM zhvilloi vizitën e parë në “Institucionin e Shtabit Ushtarak të Bashkimit Europian” (European Union Military Staff EUMS), ku u takuan dhe brifuan për çështje të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet e NATO-s dhe BE-së, Politikën dhe Strategjinë e BE-së në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Planifikimin dhe Buxhetin e Mbrojtjes në BE. Në përfundim takimi u mbyll me shkëmbimin e dhuratave nga të dy palët dhe vlerësimeve për bashkëpunimin midis dy Institucioneve në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, me qëllim trajnimin e Liderëve të ardhshëm mbi Rolin dhe Politikën e BE-së në Siguri dhe Mbrojtje.



Ceremonia

Në mjesditet e Komandës së Forcës Ajrore u zhvillua ceremonia e përfundimit të trajnimit të personelit të Qendrës së Kontroll-Raportimit (QKR) në fushën e Mbrojtjes Ajrore.

Në aktivitetet ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, ekipi i instruktorëve të palës italiane, zëvendëskomandanti i QKR, nënkolonel Myslim Rrasa, kursantët si dhe pjesëtarë të Shtabit e Komandës së Forcës Ajrore.

Në fjalën përshëndetëse, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj falënderoi ekipin e instruktorëve italianë, kryesuar nga nënkolonel Andrea Turris, për realizimin e këtij trajnimi si dhe uroi ushtarakët e Forcës Ajrore për efikasitetin e treguar gjatë këtij kualifikimi të rëndësishëm si nga ana teorike por edhe praktike. Ndër të tjera, kolonel Pulaj inkurajoi ushtarakët e Forcës Ajrore në vijimin e kurseve të tilla duke shprehur vullnetin e bashkëpunimit me Njësinë e Trajnimit për Kontrollin e Hapësirës Ajrore, Itali (RACSA) edhe në të ardhmen, me më shumë personel dhe në fusha të tjera bashkëpunimi me interes të përbashkët.

Pas përshëndetjes së instruktorit italian, kryekapter (OR9) Liaci, i cili shprehu kënaqësinë dhe vlerësoi pozitivisht përgatitjen e ushtarakëve shqiptarë, ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave dhe një foto të përbashkët.

Trajnimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me ushtrinë italiane, duke bërë të mundur kualifikimin e oficerëve të mbrojtjes ajrore të Qendrës së Kontroll-Raportimit në Komandën e Forcës Ajrore. Kursi konsistonte në pjesën teorike dhe praktike në Shqipëri me qëllim vijimin e këtij trajnimi praktik për një periudhë 6-javore në Grupin e 22-të të Integruar të Mbrojtjes Ajrore Raketore (22° Gruppo Difesa Aerea

“Bashkëpunimim me Njësinë e Trajnimit për Kontrollin e Hapësirës Ajrore, Itali (RACSA) edhe në të ardhmen”

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj: Faleminderit instruktorëve italianë dhe ushtarakëve të Forcës Ajrore për efikasitetin e treguar



Missilistica Integrata) në Licola, Itali. Trajnimi i realizuar është një hap i rëndësishëm për kontrollorët e

mbrojtjes ajrore të vendit tonë për të bërë të mundur sigurinë e hapësirës ajrore të Shqipërisë dhe të Aleancës.



“STRONG EAGLE 3”

Ekspertë të Gardës Kombëtare të New Jersey, SHBA, mirëpritën nga Forca Tokësore

Në kuadër të Planit të Bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcës Tokësore dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it (New Jersey National Guard - NJNG), SHBA, në datat 02-06 nëntor 2021, një ekip ushtarakësh të NJNG do të zhvillojnë një sërë takimesh dhe trajnimesh me efektivat e Batalionit të Dytë të Këmbësisë (b2k) në Forcën Tokësore.

Qëllimi i aktivitetit ka në fokus konsolidimin e kapaciteteve operacionale të b2k si bërthama e Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësisë (GBKL), rritjen e profesionalizmit të efektivave të b2k, për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2021 si dhe aktivitetet për vitet 2022 dhe 2023.

Ekspertët amerikanë do të vlerësojnë kapacitetet e b2k për mbështetjen me zjarr indirekt të kompanive të manovrës, si dhe aftësimin e personelit mirëmbajtës të automjeteve HMMWV në nivel taktik.

Aktiviteti do të përmbajë disa veprimtari dhe do të zhvillohet në mjesditet e Forcës Tokësore dhe në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes. Ditën e parë, më datë 3 nëntor, do të zhvillohet konferenca e partneritetit ndërmjet GKNJ-b2k, për të vizuar më pas në datat 4 dhe 5 nëntor me aktivitetet trajnuese për përdorimin e mortajave dhe për mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara të b2k



Modeli i suksesit përballë çdo sfide ka emrin Grua

Intervistoi: **MIMOZA GOLIKA**

Barazia gjinore është një fokus i rëndësishëm i Forcave tona të Armatosura dhe përfshirja e femrave në FARSH ka treguar gjithnjë e më tepër rëndësinë e perspektivave gjinore në gjithçka që bën FA. Duke njohur rëndësinë kritike të pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave dhe vajzave në të gjitha aspektet e paqes dhe stabilitetit, janë jetike rolet që luajnë ato në paqe dhe siguri. FA është e përkushtuar për zbatimin e plotë të agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë të përcaktuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Politika mbështet avancimin e barazisë gjinore përmes parimeve drejtuese të integritetit, gjithëpërfshirjes dhe integritetit.

Major Lorena Papa është Oficer Shtabi në Divizionin e Planifikimit, J-5, në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali. Gazeta “Ushtria” po e sjell major Lorena Papa në faqet e saj nëpërmjet një interviste, si një nga femrat nën uniformë dhe pse jo një ushtarake në karrierë.

Major Lorena Papa ju aktualisht mbani detyrën Oficer Shtabi në Divizionin e Planifikimit, J-5, në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali. Do të donim dy fjalë për veten për gazetën “Ushtria”

Fillimisht përpara se të vazhdojmë me intervistën, më lejon t’ju falënderoj dhe të shpreh mirënjohje për vëmendjen që gazeta “Ushtria” i ka kushtuar çështjes së barazisë gjinore në FARSH.

Kam lindur në qytetin e Lushnjes, në vitin 1981. Po në këtë qytet kam përfunduar shkollën tetëvjeçare dhe të mesme. Në vitin 2003, jam diplomuar në Fakultetin Histori – Filologji në Universitetin e Tiranës në degën Gjeografi. Ndërsa, në vitin 2004, pas përfundimit të kursit një vjeçar pasuniversitar në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, u titullova oficer në specialitetin këmbësori. Gjatë 17 viteve shërbimi në Forcat e Armatosura, kam kryer një sërë detyrash si komandant toge, Instruktor e Gjuhës Angleze, Specialist planifikimi, Oficer protokoll në Forcën Tokësore, Oficer për Përgatitjen e Skenarëve në Qendrën e Simulimit, KDS, si dhe specialiste Bashkëpunimi me NATO-n në Drejtorinë e Planifikimit në SHPFARSH. Aktualisht, mbaj detyrën Oficer Shtabi në Divizionin e Planifikimit, J-5, në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali. Gjatë karrierës ushtarake kam përfunduar një sërë kursesh institucionale dhe funksionale, prej të cilëve do të shkëpusja kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Tokësore (US Army College) në Kansas, SHBA. Mbaj titullin “Master i Shkencave” nga Fakulteti Histori - Filologji në Tiranë dhe titullin “Master of Military Arts

Ç’do eksperiencë në jetë është një mundësi

Intervistë me major Lorena Papa, oficer Shtabi në Divizionin e Planifikimit, J-5, në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Itali

and Science” nga US Army College, Kansas, SHBA.

Në 17 vite shërbimi domethënëse në FA, keni kryer një sërë detyrash, nga komandant toge dhe deri ku jeni sot. Por keni përfunduar gjithashtu edhe një numër kursesh institucionale dhe funksionale. Cila ka qenë eksperiencë më kuptimplotë dhe gjithëpërfshirëse e formimit tuaj profesional?

Karriera ushtarake është në vetvete një varg gurësh (stepping stones), ku secili ka rëndësinë e vet për formimin ushtarak. Duke kthyer kokën pas vë re se edhe funksionet apo detyrat në dukje më pak të vlerësuara, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në atë çfarë unë jam sot. Disa kanë rëndësi për atë që përfaqësojnë në rezymenë time, disa kanë rëndësi nisur nga niveli i lartë i shkëmbimit të informacionit me kolegët, eprorët dhe mentorët me të cilët kam punuar. Kryesorja, për mua është që ç’do eksperiencë të jetë një mundësi për të mësuar. Në këtë këndvështrim “Kursi i Komandës dhe i Shtabit të Përgjithshëm” (US Army Command and General Staff Course), zhvilluar në Kolegjin e Forcave Tokësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Fort Leavenworth, Kansas, ka qenë eksperiencë



më kuptimplotë dhe gjithëpërfshirëse e formimit tim profesional. Është e habitshme se sa shumë mund të mësohet gjatë një viti studimi me një program mësimor të mirëstrukturuar dhe tepër intensiv bazuar në doktrinën dhe praktikën më të mira të forcës ushtarake më elitare të planetit. Kursi është i hartuar në mënyrë të tillë që të sfidojë deri në maksimum oficerët pjesëmarrës pasi edhe detyrat që ata pritet të ushtrojnë pas përfundimit të studimeve konsiderohen sfiduese siç janë detyrat komanduese në nivel Komandant Batalioni, Oficer Shtabi në FARSH apo në Shtabet e NATO-s.

Si u gjendët ju në Kolegjin e

Forcave Tokësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Fort Leavenworth, Kansas? Si u përzgjedhët? Si ishin studimet atje dhe çfarë do të veçonit?

Kursi i Komandës dhe i Shtabit të Përgjithshëm që realizohet në SHBA mund të jetë një ndër kurset me numrin më të madh të aplikantëve nga FARSH dhe si rrjedhojë ka edhe konkurrencë të fortë. Që nga ardhja e demokracisë në Shqipëri deri më 2018 kishin përfunduar studimet në këtë kolegji 26 oficerë të FARSH, që të gjithë burra. Unë isha ushtarakja e parë grua që më jepej mundësia të ndiqja kursin duke

thyer kështu një tabu. Gjithmonë, do t’u jem mirënjohëse eprorëve të mi për mbështetjen në procesin e përzgjedhjes dhe besimin e dhënë.

Ndjekja e këtyre studimeve është privilegj dhe përgjegjësi në të njëjtën kohë. Të përfaqësosh vendin tënd në një ambient ku rreth 90% e studentëve janë ushtarakë të Forcave të Armatosura të SHBA-së dhe rreth 10% studentë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga 120 vende të ndryshme anembanë globit, është ndjenjë që nuk përshkruhet me fjalë. Fakti që isha e para grua ushtarakë, më ngarkonte me përgjegjësinë që jo vetëm të përfundoja kursin por të arrija rezultate të larta për të lënë të hapur kështu rrugën për koleget e mia në vitet pasardhëse. Dy elementët që sapo përmenda, kanë qenë burim i vazhdueshëm force për të realizuar punën studimore me orë të tejzgjatura. Gjatë periudhës së studimeve, gjithashtu të ofrohej nga kolegji mundësia për të mbrojtur një temë kërkimore në fushën “Master of Military Arts and Science”. Mbrojtja e temës nuk ishte pjesë e kurrikulës së kursit por një zgjedhje personale, pra ishte një ngarkesë shtesë në supet e atyre që zgjidhnin të ishin pjesë e programit. Procesi udhëhiqej dhe monitorohej nga një bord akademikësh ushtarakë dhe civilë



Karriera ushtarake është në vetvete një varg gurësh (stepping stones), ku secili ka rëndësinë e vet për formimin ushtarak. Duke kthyer kokën pas vë re se edhe funksionet apo detyrat në dukje më pak të vlerësuara, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në atë çfarë unë jam sot. Disa kanë rëndësi për atë që përfaqësojnë në rezymenë time, disa kanë rëndësi nisur nga niveli i lartë i shkëmbimit të informacionit me kolegët, eprorët dhe mentorët me të cilët kam punuar.



që nga testimi hyrës deri në mbrojtjen e temës dhe më pas publikimin e saj. Si grua ushtarake me një karrierë të konsiderueshme në FARSH, zgjodha të mbroja temën “Roli i Grave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” pasi në mënyrë të drejtpërdrejtë isha edhe vetë e përfshirë. Kam qenë gjithmonë e interesuar që të ketë një përafërsi barazie të ecurisë në karrierë midis burrave dhe grave. Të kuptohemi, jo barazi në numra apo përqindje por shanse të barabarta. Sigurisht, midis dy gjinive ka ndryshime biologjike por nuk ka asnjë studim që të arrijë në konkluzionin se ka diferenca në kapacitetet intelektuale. Karakteristika të tjera të një ushtaraku siç janë etika dhe përkushtimi në punë, aftësitë e të drejtuarit, besnikëria dhe besueshmëria mund të zhvillohen nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe eksperiencës në mënyrë të njëjtë, pavarësisht gjinisë. Që në fillimet e karrierës sime më ka bërë përshtypje fakti se në disa detyra/funksione, të cilat luanin dhe luajnë një rol të rëndësishëm në formimin profesional të oficerit, preferohej një burrë dhe jo një grua. Gjithashtu, numri/përqindja e ulët e oficerve/nënoficerëve (gra) në radhët e Forcave të Armatosura në tërësi sigurisht që pasqyron edhe numrin e paktë të grave që mbajnë grada të larta apo madhore. Duke reflektuar, natyrshëm lindin pyetjet: - A ka gra ushtarake që të jenë pjesë e komisioneve të karrierës? - A ka ndonjë grua ushtarake që punon për hartimin e dokumenteve të rëndësishëm të FA-së? –Kush na përfaqëson? E mbi të gjitha: Ç’ duhet bërë nga vetë ne gratë për këtë? Përgjigjet nuk janë aq të thjeshta sa pyetjet, dhe aq më pak shteruese, por sigurisht edukimi mbetet guri i themelit, ndaj edhe zgjodha këtë temë. Temë që e mbrojta me rezultat të shkëlqyer dhe që ishte një ndër punimet të cilat konkurruan për çmimin “Masteri më i mirë i vitit”.

Ju rreshtuat disa pyetje më sipër për sa i përket përfaqësimit në tërësi të grave në FARSH, ose dhe për shembull numrin e paktë të grave ushtarake që mbajnë grada të larta apo madhore. Në këndvështrimin tuaj, si është çështja gjinore në Forcat e Armatosura Shqiptare?

Është një pyetje të cilës nuk mund t’i përgjigjesh me një fjali të vetme pasi janë një sërë faktorësh të cilët duhet të merren në shqyrtim. Për të pasur një pasqyrë, tablo të qartë dhe shumë-dimensionale të çështjeve gjinore në Forcat e Armatosura Shqiptare, në këndvështrimin tim, është thelbësore të studiohet, analizohet dhe të kuptohet dimensionin kulturor dhe aspektet e shoqërisë shqiptare në periudha të ndryshme kohore. Gjatë kërkimit shkencor, u fokusova në një analizë të rolit të gruas në Forcat e Armatosura Shqiptare në periudhën kohore 1939-2018. Kontributi i gruas shqiptare në Luftën e Dytë Botërore, pozita e gruas gjatë regjimit komunist si dhe transformimi postkomunist i shoqërisë dhe i Forcave të Armatosura, përbëjnë bazën e studimit për të përcaktuar nëse roli i gruas në Forcat e Armatosura është ndikuar nga ndryshimet në mjedisin kulturor të shoqërisë sonë. Gjithashtu, janë analizuar politikat e mëparshme dhe aktuale të ndërmarra nga Qeveria shqiptare, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm në lidhje me perspektivat

gjinore. Për të kuptuar kompleksitetin e integritetit gjinor në FA, u morën në analizë edhe vende të tjera si Kanadaja, Izraeli dhe Norvegjia. Vende, të cilat, me politikat e ndjekura kanë realizuar me sukses përfshirjen e grave në të gjithë spektrin ushtarak madje edhe duke iu besuar detyra të rëndësishme komanduese dhe drejtuese në njësitë ushtarake të luftimit.

Një ndër përfundimet e dala gjatë kërkimit shkencor është se shoqëria shqiptare konsiderohet ende një shoqëri e dominuar nga meshkujt. Ndryshimi i mentalitetit dhe kulturës mashkullore të një shoqërie që i qëndron besnike rrënjëve kulturore për një periudhë të gjatë kohore është një proces kompleks dhe i gjatë. Situatat sociale, politike dhe ekonomike në Shqipëri gjatë dekadave të para të shekullit të 20-të, u dhanë burrave kushte për prodhimin e maskulinitetit hegjemonist dhe nënshtrimin e gruas në shkallë sociale. Edhe pse progresi për barazinë gjinore nën komunizëm në Shqipëri përmirësoi statusin e gruas në të gjitha sferat e jetës publike, ai mbeti i paqartë dhe shumë i diskutueshëm për lëvizjen e vërtetë femërore. Mungesa e strukturave të forta shtetërore, numri i lartë i papunësisë dhe emigracioni masiv pas rënies së regjimit komunist, ndikuan në rikthimin e koncepteve tradicionale të maskulinitetit dhe feminitetit, duke dobësuar kontributin e gruas shqiptare në sferën publike, politike dhe ekonomike në mënyrë të konsiderueshme.

Gjithçka e përmendur më sipër ka ndikuar drejtpërdrejt në kulturën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Mungesa e pranisë së grave në detyra komanduese dhe drejtuese në repartet luftarake, numri i ulët i grave në gradat e larta dhe në nivelet vendimmarrëse ushtarake janë elementë të rëndësishëm që tregojnë se pjesëmarrja e grave ushtarake shqiptare në të gjitha sferat e strukturës ushtarake është e kufizuar. Nevoja për integrimin e grave në Forcat e Armatosura bashkohet me nevojën për të mos lënë mënjanë përfshirjen e gjysmës tjetër të popullsisë në organizatën/strukturën ushtarake. Por, gjithashtu, dua të theksoj se një rol tejet të rëndësishëm në këtë proces të gjatë integrimi dhe pranimi duhet të luajmë vetë ne gratë. Në ç’ mënyrë!!!? Duke qenë më aktive, më bashkëpunuese, duke kërkuar marrjen përsipër të përgjegjësisë e duke mos u shmangur detyrave të cilat kërkojnë angazhim maksimal. Besoj fuqishëm se, me vullnet dhe siguri në vetvete dhe me mbështetjen dhe vëmendjen institucionale do t’ia dalim mbanë të përballojmë çdo sfidë, të fitojmë vendin e merituar në shoqëri dhe të jemi modele suksesi për brezat e rinj që aspirojnë të bëhen pjesë e organizatës ushtarake.

Si një ushtarake në karrierë tashmë, që ka hedhur hapat e para në FA pas përfundimit të kursit një vjeçar pasuniversitar në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, e për të vazhduar më tej me një sërë kursesh e trajnimesh, çfarë do t’iu thoshit ju më të rinjve që aspirojnë FA?

Një kandidat që aspiron t’i bashkohet FA-së, është e domosdoshme që të zotërojë një sërë karakteristikash, në mënyrë që të ketë një ecuri të kënaqshme në vitet në vijim. Nga ana tjetër pjesa civile e shoqërisë e ka të vështirë ta



perceptojë jetën ushtarake, kjo pasi aktivitetet më të rëndësishme të punës sonë janë larg syrit të publikut. Si e tillë shpesh ka edhe një perceptim sipërfaqësor mbase edhe të shtrembëruar të jetës ushtarake. Nuk ka shpjegim më të qartë dhe më të qëndrueshëm sesa t’iu tregohen të rinjve modelet e suksesit dhe shanset që ofrojnë FA-të. Shumë profesione civile kanë vështirësi për punësim. Një të riu/të reje të sapo titulluar Oficer apo Nënoficer nuk mund t’i drejtosh

pyetjen: Shkollën e mbarove por a do të mund të gjeshe punë? Pra, punësimi është i sigurt dhe të jep avantazhin për të filluar të ndërtosh karrierën në atë drejtim. Disa profesione civile bien shumë shpejt në rutinë, ndërsa kur je pjesë e FARSH që prej ditës së parë të punës përfshiheh në një jetë dinamike, kualifikimesh institucionale dhe funksionale, larmi funksionesh dhe detyrash, procese përzgjedhëse dhe gradimesh. Që të gjitha mbartin sfidat e veta, ndaj

duhet punë sistematike për të ecur përpara, pra nuk ka as kohë e as vend për rutinë. Në profesione civile, mendoj, piramida e karrierës është më e kufizuar dhe mungesa e alternativave, në një farë mënyre, ul dëshirën për vetëzhvillim. Ndërkohë që në FA ka kritere të mirë përcaktuara, ka afate kohore për t’u mbajtur, prioritete e detyrime për t’u përmbyshur. Me këtë ritëm ushtaraku kalon nga njëri funksion në tjetrin, e duke përparuar në gradë.

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike "COP26"

Stoltenberg: Ndryshimi i klimës shumëfishues i krizës, e bën botën më të rrezikshme



Marrëdhëniet e NATO-s me partnerët me të njëjtin mendim

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton Konfederatën Zvicerane

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në Konferencën COP26 të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, të organizuar nga Mbretëria e Bashkuar në Glasgow. Në Samitin e Liderëve Botërorë, Sekretari i Përgjithshëm iu drejtua tryezës së nivelit të lartë "Klima, Paqja dhe Stabiliteti: Rreziku i motit Përmas COP dhe përtej". Stoltenberg shpjegoi se si ndryshimi i klimës është tani në qendër të agjendës së NATO-s, sepse "ndryshimi i klimës është një shumëfishues i krizës, ndryshimi klimatik po e bën botën tonë më të rrezikshme". Sekretari i Përgjithshëm përshkroi veprimin që NATO po ndërmerr ndaj ndryshimeve klimatike, përfshirë vlerësimin e parë të aleancës për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në infrastrukturë, operacione dhe mjedisin e siguri. "Moti më me erë, më i lagësht dhe më i egër ka rëndësi për gjithçka që forcat tona të armatosura bëjnë. Pra, kjo do të ndikojë në stërvitjet tona, aftësitë tona dhe ne po e integrojmë këtë në planifikimin tonë ushtarak dhe zhvillimin e aftësive tona. Pra, ndryshimi



i klimës ka rëndësi për NATO-n, sepse ka rëndësi për sigurinë tonë, dhe NATO tani po i adreson këto sfida."

Z. Stoltenberg shpjegoi gjithashtu se si aleatët e NATO-s po punojnë për të reduktuar varësinë e ushtrive të tyre nga lëndët djegëse fosile, duke investuar në

zgjidhje të qëndrueshme, duke përfshirë biokarburantet dhe energjinë diellore. Ndërsa ishte në COP26, Sekretari i Përgjithshëm u takua me disa liderë ndërkombëtarë, si kryeministrin Scott Morrison të Australisë, Kryeministrin Mette Frederiksen të Danimarkës,

Presidentin Sauli Niinistö të Finlandës, Kryeministrin Naftali Bennett të Izraelit, Kryeministrin Jonas Gahr Støre të Norvegjisë, Presidentin Mohamed Ould Ghazouani të Republikës Islamike të Mauritaniës dhe Presidentin Volodymyr Zelenskyy të Ukrainës.

Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar i NATO-s pret delegacionin kolumbian në Bruksel

Më 28 tetor 2021, Divizioni i Sigurisë Bashkëpunuese i Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar të NATO-s priti një delegacion zyrtarësh ushtarakë kolumbianë për një ditë bisedimesh ndërmjet stafeve ushtarake, në selinë e NATO-s. Kolumbia është partnere e NATO-s që nga viti 2017 dhe ky është takimi i parë ushtarak që mbahet në Bruksel. Delegacioni kolumbian u prit nga Zëvendës Drejtori i Divizionit të Sigurisë së Bashkëpunimit, kolonel Martinez-Esparza përpara takimeve me stafin e Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar të NATO-s dhe Stafin Ndërkombëtar. Temat e diskutuara përfshinin luftën kundër korrupsionit dhe ndërtimin e integritetit si dhe sigurinë kibernetike dhe sigurinë detare. Delegacioni kolumbian drejtohej nga gjenerali Jorge Gonzalez Parra, Shefi i Shtabit të Përbashkët Kolumbian dhe përfshinte kundëradmiralin Jose Ricardo Hurtado, Shefin e Shtabit të Operacioneve Detare, gjeneral brigade Edgar Falla si dhe anëtarë të tjerë të Forcave të Armatosura kolumbiane. Ata u mbështetën nga Shtabi i Përfaqësimit Ushtarak kolumbian, i udhëhequr nga gjenerali Jaime Carvajal. Kolumbia është vendi partner më i ri i NATO-s. Në vitin 2019, u nënshkrua një Program i dytë Individual i Partneritetit dhe Bashkëpunimit që zyrtarizoi njohjen e Kolumbisë si partnere e NATO-s. Kolumbia dhe NATO do të bien dakord për një program të ri partneriteti në vjeshtë të 2021. Fushat e mundshme me interes për bashkëpunim të zgjeruar përfshijnë ndërveprueshmërinë, ndërtimin e integritetit, trajnimin dhe arsimin, si dhe fusha të reja si ndryshimi i klimës dhe siguria.



Mblidhet Konferenca e Drejtorëve të Armatimeve Kombëtare

Konferenca e Drejtorëve të Armatimeve Kombëtare (CNAD) zhvilloi një takim, për Plenarin e saj të Vjeshtës, me përfaqësues nga partnerët e Platformës Aleate dhe të Ndërveprueshmërisë (IP), si pjesë e ciklit të rregullt të takimeve. CNAD është një organ unik dhe i veçantë i NATO-s, misioni i të cilit është të mundësojë bashkëpunimin në ofrimin e aftësive ushtarake të ndërveprueshme për të përmirësuar efektivitetin e forcave të NATO-s në të gjithë spektrin e detyrave kryesore të NATO-s, përfshirë operacionet aktuale dhe të ardhshme. Në takim u trajtuan disa tema kryesore, përfshirë inovacionin, klimën dhe programet kryesore të NATO-s. Drejtorët e armatimeve diskutuan gjithashtu teknologjitë e reja dhe përçarëse për të kuptuar potencialin e këtyre dhe teknologjive të tjera për ofrimin e aftësive dhe për të përcaktuar veprimet, modalitetet dhe afatet kohore për t'i miratuar ato. Ata dhanë udhëzime mbi mënyrën më të mirë për të ofruar aftësi kritike për parandalimin dhe mbrojtjen sa më shpejt të jetë e mundur, nëpërmjet bashkëpunimit të përfortuar midis aleatëve dhe me Organizatën e Shkencës dhe Teknologjisë së NATO-s dhe Komandat Strategjike. Drejtorët e Armatimeve Kombëtare debatuan gjithashtu arritjet e programeve kryesore të aftësive të NATO-s, si dorëzimi i komponentëve kryesorë të sistemit të mbikëqyrjes tokësore të Aleancës (AGS) në NATO dhe pranimi i tyre operacional; arritjen e fazës tjetër të angazhimeve të industrisë për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Ardhshëm të Aleancës në formën e Studimeve të Riskut dhe Fizibilitetit. Ata mirëpritën gjithashtu nisjen dhe zbatimin e suksesshëm të një numri të madh iniciativash bashkëpunimi shumëkombësh e të mbështetura nga NATO, që u mundësojnë aleatëve të zhvillojnë dhe të fitojnë aftësi, si dhe të stërviten dhe të ushtrohen së bashku. Takimi i radhës për Konferencën e Drejtorëve të Armatimeve Kombëtare do të zhvillohet në pranverë 2022, në formatin aleat.

Në datat 28-29 tetor 2021, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Mircea Geoană, udhëtoi për në Konfederatën Zvicerane. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u takua me zyrtarë të nivelit të lartë nga organizatat ndërkombëtare dhe palë të tjera relevante ndërkombëtare, si z. Houlin Zhao, Sekretar i Përgjithshëm i Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, znj. Olga Algayerova, Sekretare Ekzekutive e Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën dhe z. Borge Brenda, President i Forumit Ekonomik Botëror. Këto takime mbështesin programin dhe vendimet e NATO-s 2030 për të zgjeruar dhe forcuar marrëdhëniet e NATO-s me partnerët me të njëjtin mendim, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare. Në angazhimet e tij, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm ripohoi përkushtimin e NATO-s ndaj rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ai diskutoi agjendën aktuale të NATO-s, me theks të veçantë për inovacionin dhe teknologjitë në zhvillim; elasticitetin dhe ndryshimet klimatike.

Më 29 tetor, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë në tryezën e rrumbullakët Chambésy për Sigurinë Evropiane të organizuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA) dhe Qendra e Gjenevës për Politikën e Sigurisë (GCSP). Ai u takua gjithashtu me zëvendësministrin e Jashtëm të Rusisë, Alexander Grushko, znj. Helga Schmid, Sekretare e Përgjithshme e Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE) dhe ambasadorin Thomas Greminger, Drejtor i Qendrës së Gjenevës për Politikë të Sigurisë (GCSP).

Zvicra është një partner afatgjatë dhe i vlerësuar për NATO-n. Bashkëpunimi dypalësh filloi kur Zvicra iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në 1996 dhe u bë anëtare e Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC) në 1997.

SIGURIA RAJONALE DHE PARTNERITETI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Kaukazin dhe Azinë Qendrore bën vizitën e tij të parë në Kaukazin e Jugut

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Kaukazin dhe Azinë Qendrore, z. Javier Colomina, udhëtoi në Kaukazin e Jugut duke vizituar Azerbajxhanin, Gjeorgjinë dhe Armeninë për t'u prezantuar në cilësinë e tij të re. Ai diskutoi çështjet e sigurisë rajonale me zyrtarë të nivelit të lartë civil dhe ushtarak, vlerësoi marrëdhëniet e NATO-s me këta partnerë të rëndësishëm dhe ndau pikëpamjet mbi dialogun dhe bashkëpunimin e ardhshëm politik, veçanërisht në kontekstin e përgatitjeve të vazhdueshme për Samitin e NATO-s 2022 në Madrid. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm shprehu vlerësimin për mbështetjen e Azerbajxhanit për NATO-n në Afganistan, dhe veçanërisht për rolin e luajtur nga njësitë e Azerbajxhanit në mbështetjen e përpjekjeve të evakuimit të personelit aleat dhe partnerëve dhe afganëve në rrezik, nga aeroporti i Kabulit, gushtin e kaluar. Ai dëgjoi pikëpamjet mbi sfidat me të cilat përballet Azerbajxhani pas luftës 44-ditore. Ai gjithashtu shqyrtoi bashkëpunimin aktual NATO-Azerbajxhan, duke përfshirë rifillimin e bash-

këpunimit me autoritetet e Azerbajxhanit brenda kornizës së partneritetit të Procesit të Planifikimit dhe Rishikimit. Në Gjeorgji, z. Colomina shprehu mbështetjen për aspiratat euroatlantike të Gjeorgjisë dhe theksoi rëndësinë e çarjes përpara të reformave në fushat kyçe, përfshirë reformën në drejtësi, mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë dhe reformën zgjedhore. Ai vlerësoi Gjeorgjinë për kontributin e saj të vazhdueshëm në sigurinë euroatlantike dhe për mbështetjen e saj ndaj operacioneve të NATO-s, përfshirë përpjekjet për evakuim nga Kabuli këtë verë, si dhe rolin konstruktiv të Gjeorgjisë në rajon. Ai gjithashtu vizitoi Vijën Kufitare Administrative ku përsëriti mbështetjen e NATO-s për integritetin territorial të Gjeorgjisë brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Pozicioni i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Kaukazin dhe Azinë Qendrore u krijua për të vendosur një fokus të veçantë në këto dy rajone të rëndësishme strategjike për Aleancën Atlantike, pas vendimit të marrë nga aleatët e NATO-s në Samitin e Stambollit në qershor 2004.



Arsimimi i lartë ushtarak, sfidë për sigurinë dhe transformimin e mbrojtjes së vendit

N/KOL (R), MCS. KANAN HIMAJ
Specialist në Institutin
e Kërkimeve Ushtarake

Sot, arsimi i lartë është kthyer në rendin e ditës, jo vetëm për forcat e armatosura por për tërë shoqërinë shqiptare. Tashmë, zhvillimet në sistemin e mbrojtjes kanë objekt të rëndësishëm cilësinë e punës për të transformuar institucionin e arsimit të lartë ushtarak. Jo vetëm kaq, por përkujdesja ndaj çështjeve që lidhen vërtetë me sfidat e arsimit, sidomos të programit bachelor, kërkojnë potencial shkencor në drejtim por edhe në përgatitjen e tërë stafit mësimdhënës. Arsyt janë shumë, por kthesa që po bëhet, siç shprehet në vijimësi lidhshipi, kërkon përkujdesjen e duhur që ai të zhvillohet në cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat. Në kushtet tona, aspekt i rëndësishëm, arsimi është sa ushtarak profesionist aq edhe një fenomen i rrënjësor thellë në shoqëri për çështje të mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë kuptim, theksojmë disa aspekte të rëndësishme që lidhen edhe me kushtet e sotme të transformimit të arsimit të lartë ushtarak, duke theksuar rolin e tij për sigurinë: (1) aspektet e arsimit në AFA; (2) koncepti i burimeve njerëzore, si një marrëdhënie social-kulturore midis arsimit dhe sigurisë, dhe (3) implikimet e arsimit për zhvillimin e ardhshëm në FA. Pra, tërë zhvillimet e pritshme, në fund do të jenë lidhje e arsimit të lartë ushtarak me zhvillimet në FA, si ndër elementët më të rëndësishëm të sigurisë kombëtare. Moment i veçantë që është pjesë e sfidës do të mbetet niveli shkencor por edhe akademik i trupës mësimdhënëse, ushtarako-civile, e cila ka rol të madh, jo vetëm në përmirësimin e cilësisë të arsimit por në shtytjen përpara të treguesve realë në FA.

Në këtë aspekt, përkujdesja do të bëjë të mundur të startojë në specifikimin në detaje të rolit të tanishëm të arsimit ushtarak në tërësi për mbështetjen reale të proceseve transformuese të FA-së. Është vërtetuar se siguria kombëtare varet ndjeshëm nga gjendja e arsimit, pasi ajo merr përsipër detyrat më të rëndësishme për shoqërinë, mënyrën e kualifikimit në të gjithë sektorët, pra përgatitjen e gjeneratës së re të personelit ushtarak por edhe civil.

Pritshmëria e sistemit arsimor është që ai të zhvillohet me modelet më të reja të arsimit të lartë në vend. Ai do të marrë pjesën më të mirë të gjithë përvojës së arsimit të lartë dhe do të gërshetojë përvojën e deritanishme të përgatitjes dhe kualifikimit të personelit në FA, duke marrë parasysh dinamikën e mjedisit sigurisë dhe evolucionit të shkencës dhe artit ushtarak. Në këtë kontekst, ai do të përfshijë gjerësisht informacionin e teknologjive, do të ofrojë një proces mësimi të orientuar drejt përvojës aktive dhe praktike, i cili do të inkurajojë aftësitë e të menduarit teorik, praktik dhe kritik të studentët, oficerët dhe lidhshipi.

Akademia e FA-së do të formulojë një kompleks institucional të cilësive të veçanta në raport me arsimimin e përgjithshëm publik dhe privat duke rritur ndërveprimin dhe sendërgjinë mes njëri-tjetrit. Zhvillimi i arsimit të lartë ushtarak do të kryhet, duke ndjekur konceptet e miratuara në bazën ligjore themelore të zhvillimit të FA-së.

Kurrikulat dhe programet mësimore do të azhurnohen dhe programet e reja arsimore do të përpunohen në fushën profesionale të Shkencës Ushtarake, në përputhje me përparimin e teknologjive dhe shkencës ushtarake.

Në këto kushte, në periudha të ndryshme të historisë është vërtetuar se siguria kombëtare varet ndjeshëm nga gjendja e arsimit, pasi ajo që merr përsipër detyrat më të rëndësishme për shoqërinë për të trajnuar korpusin e gjerë të personelit dhe jo vetëm ushtarak profesionist, elitën e shoqërisë, ndikon në ndryshimet në strukturën shoqërore të shoqërisë dhe formon pikëpamjet për çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit.



Studiuesit e problemeve të sigurisë kombëtare, besojnë se niveli i zhvillimit arsimor është më i rëndësishmi si tregues i brendshëm i sigurisë kombëtare. Nga arsimi sigurohet shoqëria me qasje në njohuri, një mundësi për të marrë pjesë në krijimin e vlerave shpirtërore dhe asimilimin e arritjeve kulturore.

Nga ana tjetër, studiuesit veçojnë disa funksione të veçanta sociale të edukimit: mbrojtje sociale, e cila lejon një person të zgjerojë potencialin social, mundësitë në vetëvendosje profesionale dhe personale, veçanërisht nën kushtet e tregut; funksioni humanist, i cili thekson vlerën arsimore, aspektet brenda subjektivit të veprimtarisë në aspektin subjektiv-objektiv; funksion urbanistik, i cili përqendrohet në ndikimin e arsimit në proceset e migrimit (është më e rëndësishme në kontekstin e arsimit të lartë); funksioni demografik, i cili thekson rëndësinë e faktorëve kulturorë dhe arsimorë në demografinë e proceseve të shtetit (përbërja e popullsisë, jetëgjatësia, martesë/marrëdhëniet, e kështu me radhë); funksioni i trashëgimisë historike të përvojës shoqërore, e cila riprodhon natyrën e marrëdhënieve me botën e jashtme dhe pasqyron shumëllojshmërinë e strukturës sociale dhe të rolit të shoqërisë.

Nisur edhe nga qëllimi i këtij shkrimi, është me rëndësi të zhvillojmë ndjenjën e marrëdhënieve të ngushta midis sistemit arsimor dhe sigurisë kombëtare të shtetit. Strukturat arsimore zënë një nga vendet kryesore në zhvillimin e sistemit të vlerës. Më shumë se dy mijëvjeçarë më parë, Aristoteli me të drejtë vuri në dukje se arsimi është «një funksion i kryer nga shteti për të përcaktuar mirë qëllimet specifike». Në perspektivën e vetë akademisë së arsimit të lartë ushtarak është e rëndësishme të veçohen ato grupe vlerash që luajnë një rol vendimtar në ekzistencën e shtetit shqiptar dhe sigurinë kombëtare. Sigurisht, është e zakonshme të specifikohen katër «bazat» e shtetësisë - territori,

popullsia, burimet dhe kultura.

Në procesin e zhvillimeve të reja, në Akademinë e Forcave të Armatosura, kujdesi tregohet për vlerat kulturore që çdo individ duhet të ndajë, që mësimi dhe edukimi të përfshijë vlerat kulturore të shkencës, artit, moralit, ligjit, ekonomisë. Vetë lidhshipi dhe drejtuesit në Akademinë e Forcave të Armatosura janë të bindur se edhe shkenca ka pranuar në konsensus të përgjithshëm se pa një kulturë të re, pa trajnim inovativ në të gjitha drejtimet dhe etapat e ndryshmeve të pritshme është e destinuar për dështim.

Sot, në tërësi përcaktohet niveli i zhvillimeve të mbrojtjes dhe sigurisë duke marrë parasysh progresin e civilizimit nga niveli i zhvillimit të burimeve njerëzore, si parakusht kryesor për krijimin e potencialit shkencor, ekonomik, social, kulturor dhe shpirtëror. Kjo është një fushë e gjerë ku, vendet partnere dhe të zhvilluara luftojnë në vazhdimësi për të rritur nivelin e sigurisë, ruajtjen e zhvillimit dhe të zgjidhjes së sfidave politike, ekonomike, kulturore, e deri ato të sigurisë të cilat janë treguesi i rëndësishëm për çdo shtet. Në dritën e këtyre perspektivave, arsimi dhe shkenca, diapazoni, niveli dhe cilësia e tyre po bëhen faktorët kryesorë, vendimtarë në zhvillimin dhe mbështetjen e sigurisë kombëtare.

Roli i arsimit në fazën aktuale të zhvillimit të vendit tonë përcaktohet nga detyrat e transformimit të vendit në një shoqëri demokratike, në një shtet të rregulluar nga shteti i së drejtës, një shtet me ekonomi tregu, nga detyrat për të përballuar çdo kërcënim. Në këtë drejtim, arsimi duhet të konsiderohet si çështje kryesore, përparësie dhe me synime afatgjata.

Aktualisht, gjithëpërfshirja dhe modernizimi i thellë i sistemit arsimor është detyra më e rëndësishme e politikave arsimore, prirja kryesore strategjike. Në epokën e globalizimit dhe teknologjive të reja, kjo nuk është vetëm një sferë sociale. Ky është një investim në të ardhmen e vendit, në

mbështetjen e sigurisë së saj kombëtare, kjo është një detyrë e shtetit dhe shoqërisë, organizatave dhe qytetarëve. Arsimi mbulon të gjitha nivelet e sigurisë: shoqërinë, shtetin, individin. Pra, është mjaft e qartë se siguria ekonomike dhe ushtarake e shtetit është e pamundur pa personel të kualifikuar, ndërsa siguria teknologjike është e pakënaqshme pa kërkime shkencore.

Duke folur për rolin e arsimit dhe politikës arsimore në mbështetje të sigurisë kombëtare, duhet theksuar se arsimi prek të gjitha nivelet e sigurisë së vendit (siguria e shoqërisë, shtetit, individit) dhe të gjithë elementëve strukturorë të saj.

Arsimi i lartë ushtarak është përbërësi më i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, dhe bëhet më i rëndësishëm kur niveli i zhvillimit të tij kërkon të zgjidhë sfidat e kohës. Disa studiues theksojnë disa mungesa të cilat mbeten sfida për t'u kapërcyer si mungesa e mbështetjes financiare dhe materiale të institucioneve arsimore; pasiviteti dhe mosgatishmëria e të rinjve për të marrë njohuri, tregues të ulët në aftësi; mungesa të kualifikimit të stafit mësimdhënës; nivel i ulët i profesionit të mësimdhënësit etj.

Duke analizuar gjendjen e arsimit modern ushtarak dhe aspektet e tij, duhet të theksohet: së pari, përhapja e arsimit dhe ndikimi i tij në shoqërinë shqiptare; së dyti, identifikimi i mospërputhjeve në sferën arsimore; së treti, përshkrimi i sistemit të arsimit të lartë ushtarak në institucionet arsimore dhe ndërveprimin midis tyre; së katërti, studime empirike të efikasitetit të metodave të mësimdhënies të përdorura dhe kualifikimi shkencor në të gjitha nivelet.

Qëllimi kryesor i modernizimi të arsimit ushtarak nuk është vetëm azhurnimi i përmbajtjes së tij, por edhe zhvillimi i personalitetit si lider, aftësitë krijuese, pavarësia e tij, iniciativa dhe përpjekja për vetë-arsimim. Në kontekstin e një fushe të re shoqërore dhe kulturore, qëllimi i tij është të plotësojë nevojën e individit për vetë-realizim përmes përdorimit të aftësive të mundshme për të menduar, komunikuar dhe drejtuar.

Ndikimi i arsimit në sigurinë e një vendi përcaktohet nga fakti se sa e rrit nivelin e intelektualit, sa lejon mësimin dhe përvetësimin e teknologjisë, deri në çfarë mase drejton drejt zgjidhjes së problemeve kryesore me të cilat mund të përballen nesër. Roli i arsimit të sotëm në procesin e integritetit të vendit është domethënës, prandaj, është thelbësor për të ndërlidhur konceptet dhe programet e shkollave publike, programeve rajonale për zhvillimin e arsimit dhe të krijojnë një koncept të arsimit. Arsimi, përveç zgjidhjes së tij të brendshme, lidhet drejtpërdrejt për proceset e ndërtimit të shtetit, mbrojtjen e vendit dhe reformat në ushtri, sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, harmonizimi i marrëdhënieve brenda një hapësire të unifikuar shtetërore.

Arsimi dhe jo vetëm ai ushtarak është themeli i mirëqenies dhe sigurisë së ardhshme të vendit, duke marrë parasysh që sistemi arsimor ndikon në mënyrë aktive në zhvillimin modern, material dhe shpirtëror; krijon dhe formon forcën kryesore të intelektualit në shoqëri; ndikon në proceset e ndryshimit të strukturës shoqërore; është mjete më e rëndësishme për të transferuar tek të rinjtë vlerat më të mira morale; formaton pikëpamjet politike të njerëzve dhe jep aftësitë fillestare të veprimtarisë shoqërore; mbetet themeli i tërë zhvillimeve të kulturës të shoqërisë dhe të vlerave më të mira të mbrojtjes dhe sigurisë, etj.

Në përfundim, ne kemi pranuar në të gjitha format se cilësia e arsimit ka dhënë pozitivitetin dhe rezultatet më të larta në modernizimin e shoqërisë në tërësi dhe të mbrojtjes në veçanti. Cilësia e arsimit ndikon ndjeshëm në faktin nëse pagja civile është e garantuar për shoqërinë, e drejta për të pasur bindje të veta është e siguruar për të gjithë ata që marrin kulturën e duhur për të zgjidhur sfidat e kohës.

"Skënderbegasi"

Në panteonin e vlerave të kombit shqiptar

PUNOI: ANJEZA MUSOLLARI

Legjenda e kuqe Panajot Pano

1 vite pa të madhin Panajot Pano, një nga figurat më të njohura të futbollit shqiptar dhe Partizanit, ndërroi jetë në moshën 71-vjeçare në Jacksonville, Florida, SHBA.

Pano i cilësuar si "Legjenda e Futbollit" shqiptar përgjatë karrierës së tij 18- vjeçare si futbollist me performancën e shkëlqyer dhe golat e shënuar ka dhuruar emocione të paharrueshme për publikun shqiptar.

Me fanellën e Partizanit Pano në 210 ndeshje të luajtura do të realizonte plot 136 gola duke fituar me të kuqtë 4 Tituj Kampion dhe 5 Kupa, ndërsa me përfaqësuesen e Shqipërisë rregjistroi 24 ndeshje duke shënuar edhe 4 gola.

Një karrierë e shoqëruar me shumë lavdi dhe mjaft tituj individual përfshirë:

"Mjeshtër i Merituar i Sportit"

"Lojtari më i mirë i të gjitha kohërave" akorduar nga FSHF në vitin 2003

"Lojtari i Shekullit" akorduar nga Uefa/Fifa

"Nderi i Kombit" akorduar nga ish presidenti republikës Bamir Topi në vitin 2009

"Simboli Qytetit të Tiranës" titull i akorduar nga kryetari Bashkisë Erion Veliu në vitin 2017

Figura e Panajot Panos dhe emri i tij mbetet gjithmonë i paharruar në mendjet dhe zemrat, sidomos të tifozerisë së Partizanit, skuadër me të cilën fitoi gjithçka duke shënuar një dominim absolut të asaj periudhe në futbollin shqiptar.

PANAJOT PANO, FENOMENI I BALLKANIT
Cili është përkufizimi i 'fenomenit'?

Fenomen është ai futbollist që ka aftësi të lindura teknike, shumë mbi normalen. Fenomen është ai që ka aftësi teknike të jashtëzakonshme, aq sa të bësh një vlerësim do ishte e panevojshme, qartësisht e dukshme dhe pa asnjë mundësi për t'a hedhur poshtë. Pele, Maradona, Cruyff mund të cilësohen si fenomene, ashtu si dhe shumë të tjerë. Por një emër duhet thënë, një emër që nuk ka asnjë dyshim edhe pse i panjohur për publikun e gjere. Po flasim për "Jotin", Panajot Panon.

Panajot Pano lindi në Durrës, por "takimi" me futbollin do të ndodhte në Tiranë, aty ku familja Pano do të transferohej në kërkim të një jete më të mirë. Në Tiranë, vendin e një mijë mundësive për të rinjtë shqiptarë, Panajotit do t'i jepej një mundësi e vetme, por e mjaftueshme për t'i dhënë një kthesë jetës së tij: Një top futboll. "Prindërit e mi nuk ishin dakord që të luaja me top gjithë ditën, në vend që të studioja". Një kundërshtim që s'duhet të ketë zgjatur për shumë kohë. Nga ndeshjet në rrugë, Pano kalon tek të rinjtë e KF Tirana.



Aftësitë e tij ranë menjëherë në sy, por jo ato aftësi që mund të mendoje. Pano, në fakt, është një portier i shkëlqyer.

Po, por në fillim të karrierës së tij. Deri kur ishte 17 vjeç, Pano luante në portë dhe me duar. Çfarë fillimi të çuditshëm kanë karrierat e mëdha.

Hiqi ato dorashka! Pas pak kohesh, vjen edhe kthesa. "Joti, dil në nxemje. Tani do futesh. Por në sulm" i thotë trajner Demneri, që i dha shansin për herë të parë të0 riut shqiptar në skuadrën e parë. KF Tirana e humbi ndeshjen 4 - 0.

Jo një debutim për t'u mbajtur mend, por nuk e mendonte kështu

Demneri, që filloi të jepte më shumë besim dhe më shumë minuta. Dhe kështu, në më pak se një vit Pano bëhet titullar i padiskutueshëm, duke i lënë mbas veteranët me gola dhe paraqitje. Një karrierë që filloi të merrte formë, por që shpejt u ndërpre, pasi Pano ishte i detyruar të kryente shërbimin ushtarak, si të gjithë të rinjtë e tjerë në atë kohë. Pavarësisht kësaj, nuk hoqi kurrë dorë nga futboll. Ushtarët shqiptarë në fakt, argëtoheshin duke i luajtur futboll gjatë kohës së lirë. Klasi i tij nuk mund të mos binte në sy. Një vëzhgues i Partizanit, (skuadra e ushtrisë) e vuri re dhe bëri gjithçka që t'ja prezantonte trajnerit. Dhe këtu fillon legjenda e të madhit Pano dhe e Partizanit. Pano, pak më shumë se 20 vjeçar, u mor për të qenë titullar.

Lëvizje plotësisht e goditur. Kryegolashënues me 12 gola, fiton edhe titullin në sezonin e tij të parë. Fillimi i sukseseve të mëdha të skuadrës shqiptare, që dominoi vitet '60 në nivel kombëtar dhe jo vetëm. 4 kampionate kombëtare, 6 Kupa të Shqipërisë dhe një Kupë Ballkani për klube.

Panajot Pano futbollisti 'elegant' i shpejtë si shigjetë, rezistent dhe i fortë në të njëjtën kohë, aq shumë sa t'i garantonte një forcë shumë të madhe. Cilësia e fundit dhe më e rëndësishme, këmbët magjike. Prekje e lehtë kur duhej, e dhunshme dhe potente në momentin e duhur.

Legjendat shqiptare një muzë frymëzimi për të rinjtë e të gjitha kohërave!

Yje me shkëlqim të përjetshëm!

Lojtarët e Partizanit që kanë fituar "Këpucën e Artë"

1947 – Hamdi Bakalli	(7 gola)
1948 – Zihni Gjinali	(11 gola)
1949 – Zihni Gjinali	(13 gola)
1950 – Loro Borici	(9 gola)
1951 – Refik Resmja	(59 gola)
1952 – Refik Resmja	(17 gola)
1953 – Refik Resmja	(9 gola)
1954 – Refik Resmja	(13 gola)
1955 – Refik Resmja	(23 gola)
1956 – Refik Resmja	(17 gola)
1959 – Refik Resmja, Panajot Pano	(6 gola)
1961 – Panajot Pano	(14 gola)
1962/63 – Panajot Pano	(17 gola)
1965/66 – Robert Jashari	(14 gola)
1970/71 – Panajot Pano	(17 gola)



Partizani, ndryshe Skuadra e Ushtrisë Kombëtare apo Popullore, siç do të thirrej pak më mbas, do të përcaktonte fatin e vetë ecurisë, zhvillimit, organizimit, politikës së futbollit, madje të të gjithë sportit shqiptar.

Partizani krijonte një aureolë gjigante rreth vetes, çka e bënte atë sunduesin e paprekshëm të vetë futbollit shqiptar. I diferencuar në kushte, qysh ditët e para të krijimit të tij, i fuqizuar me talente të vërtetë, gjithmonë nën fuqinë e petkut të paprekshëm ushtarak, Partizani i Shqipërisë shumë shpejt do të shndërrohej në një klub të përmasave të mëdha dhe mbasi ndërtohet sipas stilit të të gjithë klubeve ushtarake të asaj kohe, kishte për ta ruajtur mbretërinë e tij solide për rreth 40 vite me radhë. Kampionati i 10-të fillon më 16 mars 1947 dhe nuk fillon mirë: në çastin e fundit futet në kampionat skuadra e Gjirokastrës, duke e bërë nga 8 në 9 numrin e pjesëmarrësve dhe kalendari i hedhur pak ditë më parë bie poshtë për t'u përpiluar shpejt e shpejt një i ri.

Kampionati i 10-të Kombëtar i Shqipërisë kishte fituar mjaft elementë të rinj.

Skuadra e Partizanit e arriti objektivin e vet duke u përshkuar nëpër një përparim gradual dhe të sigurt. Loja e tij gjatë ndeshjeve të kampionatit, fitoi gjithnjë e më tepër forcë, vitalitet, stil, harmoni dhe pikërisht në periudhën e sulmit përfundimtar për të fituar titullin kampion, skuadra ushtarake që në të njëjtën kohë qe edhe skuadra shembullore e rregullit, e disiplinës, e vëllazërimit, erdhi në një formë të shkëlqyer".

1951 RESMJA REKORD ABSOLUT NË FUTBOLLIN SHQIPTAR

- 7 herë kampion i Shqipërisë
- 4 herë fitues i kupës së Shqipërisë
- 8 herë golashënuesi më i mirë i kampionatit
- 59 gola të Refik Resmes të vitit 1951

Golashënuesi i dytë më i mirë në historinë e kampionatit Shqiptar. Emri i Refik Resmes gdhendet në librin e artë të golashënuesve të UEFA-s. Ai renditet i gjashti në renditjen e golave të shënuar për 1 sezon. Me një ndeshje Refik Resmja vendos një rekord absolut në futbollin shqiptar për numrin e golave të shënuar në një sezon. Asnjë futbollist shqiptar nuk ka mundur ende të barazojë apo t'i afrohet këtij rekordi fantastik.

IFFHS, Federata Ndërkombëtare e Historisë dhe Statistikave, e ka renditur sulmuesin e Partizanit në vendin e pestë në klasifikimin e publikuar me 11 golashënuesit më të suksesshëm të Botës, për numrin e golave të shënuar brenda një kampionati kombëtar të një shteti.

Përfaqësues i futbollit të largët të 70 viteve më parë, i origjinalitetit të shënimit të golave që janë te veshura plot art, mbeten të paarrtshëm deri më sot. Më 1958, në Lajpcig i patën dhënë një Kupë për interpretimin madhështor të goditjes së tij në ajër nga mbrapa (rovesciata).

Yje që shkëlqimin e tyre e kanë të përjetshëm!

Mirënjohje për emrin që kanë lënë në fushën e blertë, djemtë e fanellës së kuqe.

10 marinat më të fuqishme në botë

Gazeta "Ushtria do të botojë në numrat e ardhshme marinat më të fuqishme në botë"

Marina Amerikane

Marina amerikane aktualisht është marina më e aftë në botë. Në fillim të viteve 1990, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, marina amerikane ka zhvendosur fokusin e saj nga skenari i luftës në shkallë të gjerë me Bashkimin Sovjetik në konfliktet rajonale. Flota amerikane vazhdon të tkurret për shkak të zvogëlimit të fondeve dhe mungesës së kërcënimit të duhur, megjithatë kryesisht me një kosto të anijeve më të vogla, sesa atyre luftarake me sipërfaqe më të madhe dhe nëndetëse më vdekjeprurëse. Flota amerikane po mirëmbahet mirë. Anijet dhe armët e reja vazhdojnë të dalin. Marina amerikane ka gati 320,000 personel.

Marina amerikane operon me 11 transportues të mëdhenj aeroplanësh, që përdoren për të prodhuar energji. Këto përfshijnë një transportues të vetëm të klasit "Ford" dhe gjithsej 10 transportues avionësh të klasit "Nimitz" dhe të përmirësuar të klasit "Nimitz". Secili prej këtyre transportuesve të avionëve ka 70-80 avionë. Transportuesit e avionëve janë vendosur në grupet luftarake të transportuesve së bashku me një mori anijesh luftarake shoqëruese dhe nëndetëse sulmuese. Këto anije dhe varka shoqëruese ofrojnë mbrojtje për transportuesit nga kërcënimet ajrore, raketore, detare dhe nënujore. Gjithashtu këto anije shoqëruese ofrojnë edhe vetë aftësi shtesë sulmuese.

Marina amerikane ka një aftësi të konsiderueshme sulmi amfib. E ashtuquajtura "gator navy" operon 8-9 anije të klasit "Amerikan" dhe anije sulmi amfib të klasit "Wasp". Secila prej këtyre anijeve luftarake mbart rreth 1 700-2000 marinsa, si dhe automjetet e tyre të blinduara, dhe i çon në breg me tiltrotorë, helikopterë dhe mjete ajrore. Këto anije luftarake janë më të mëdha se shumica e transportuesve të avionëve. Për më tepër, ekzistojnë 11 transportues të mëdhenj amfibë të klasit "San Antonio" që gjithashtu ofrojnë aftësi amfibe me rreze të gjatë. Trupat Detare të SHBA-së kanë më shumë se 180 000 anëtarë personel dhe aviacionin e tyre detar, edhe pse ky shërbim nuk lidhet drejtpërdrejt me Marinën Amerikane.

Marina Amerikane ka 22 kryqëzorë raketash të klasit "Ticonderoga". Këto ishin anijet e para luftarake sipërfaqësore të pajisura me sistemin e armëve AEGIS, sistemi më i sofistikuar i mbrojtjes ajrore në botë. Këto kryqëzorë janë krijuar për të mbrojtur grupet e betejës nga sulmet me raketa.

Marina amerikane po ndërton 3 shkatërrues jashtëzakonisht të avancuar dhe të fshehtë të klasit "Zumwalt". Këta janë shkatërruesit më të mëdhenj të ndërtuar ndonjëherë. Në fakt për sa

i përket madhësisë, zhvendosjes dhe armatimit, anijet e klasit "Zumwalt" janë më afër kryqëzorëve sesa shkatërruesve. Këto anije luftarake janë të fokusuara në sulmet tokësore, por gjithashtu mund të kryejnë mbështetje kundër zjarrit, kundërajrore dhe detare. Gjithashtu ka 64 shkatërrues me funksion të përgjithshëm të klasit "Arleigh Burke", që përfshijnë armë dhe sisteme shumë të përparuara.

Marina Amerikane nuk ka fregata që shërbejnë. Këto u zëvendësuan kohët e fundit nga anijet luftarake bregdetare të klasit "Freedom" dhe "Independence". Këto anije të vogla mbajnë fare pak armë dhe nuk janë krijuar për të luftuar anije luftarake të së njëjtës madhësi.

Marina amerikane operon me një total prej 3 nëndetësesh sulmuese të klasit "Seawolf" të fuqisë bërthamore. Këto anije janë shumë më të avancuara sesa anijet që operojnë vendet e tjera. Gjithashtu ka 14 anije të teknologjisë së fundit të klasit "Virxhinia" dhe 35 anije më të vjetra të klasit "Los Angeles" në shërbim.

Janë gjithsej 14 anije aktive të klasit "Ohio" që mbajnë raketa balistike me


majë bërthamore. Këto nëndetëse të raketave balistike kanë zona patrullimi në ujërat afër SHBA-së ose në pjesët më të largëta të oqeanëve të botës, duke

i bërë praktikisht të pamundura masat efektive kundër nëndetësve.

Marina amerikane operon mbi 3700 avionë. Shumica e tyre janë avionë luf-

tarakë me shumë role të serisë F/A-18, si dhe avionë të tjerë të lidhur, që janë vendosur në transportuesit e avionëve.





“Gjeneral Clark më përgëzoi për spektrin e gjerë dhe të suksesshëm të angazhimeve tona, me theks në pjesëmarrjen tonë efektive në operacionin humanitar mbështetës të NATO-s, për akomodimin e refugjatëve afganë të udhëhequr nga ushtria amerikane, si dhe përmbylljes me sukses të misionit të parë të FSK-së jashtë vendit”.



Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj

“Përgëzimet e Gjeneral Wesley Clark për sukseset tona janë inkurajim i madh dhe motivim i veçantë për fuqizimin e synimeve tona”

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj ka zhvilluar një takim virtual me gjeneralin Wesley Clark. “Përgëzimet e Gjeneral Wesley Clark për sukseset tona janë inkurajim i madh dhe motivim i veçantë për të vazhduar edhe më fuqishëm drejt synimeve tona. Krahas takimeve, prezantimeve e diskutimeve gjatë vizitës në SHBA, konsultimet me Gjeneral Clark janë shumë të rëndësishme në secilin angazhim. Në bashkëbisedimin e sotëm me të, diskutuam për zhvillimet e fundit gjeopolitike në rajon, me fokus në rolin e Kosovës në këto rrethana sfiduese për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë”, -ka shkruar Mehaj.

Më tej ministri thotë se “Gjeneral Clark më përgëzoi për spektrin e gjerë dhe të suksesshëm të angazhimeve tona, me theks



në pjesëmarrjen tonë efektive në operacionin humanitar mbështetës të NATO-s, për akomodimin e ref-

ugjatëve afganë të udhëhequr nga ushtria amerikane, si dhe përmbylljes me sukses të misionit të parë të

FSK-së jashtë vendit”.

“Me gjeneral Clark u dakorduam për vazhdimin e konsulti-

meve të rregullta, në funksion të realizimit të qëllimeve dhe objektivave strategjike. Gjeneral Clark edhe këtë herë shprehu përkrahjen e plotë dhe të pakursyer për mbështetje nga eksperiencia profesionale dhe autoriteti i tij shumë i lartë, për Ministrinë e Mbrojtjes.

Falënderim dhe mirënjohje e përjetshme për Heroin tonë, Gjeneral Clark dhe të gjithë autoritetet vendimarrëse amerikane për gjithçka që keni bërë dhe jeni duke bërë për Kosovën dhe botën demokratike! Kosova dhe populli i saj nuk harron mbështetjen tuaj, prandaj është dhe do të jetë gjithmonë përkrahë jush, si vendi dhe populli më pro amerikan në botë”.

“Gratë në Energji”

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK) vazhdon të hapë dyert për vajzat dhe gratë, përmes programit “Gratë në Energji”. 25 pozicione të reja tani janë të hapura për vajzat dhe gratë që janë të interesuara t’i bashkohen këtij sektori edhe nëse studimet e tyre paraprake nuk janë të po të njëjtës fushë.

Përveç kompanive dhe organizatave lidere në sektorin e energjisë, që ishin bashkëpunëtore të MFK-së që nga fillimi i programit, kësaj vale të re të mundësive për punë praktike i janë bashkuar kompani të tjera nga komuna të ndryshme të Kosovës, përfshirë Istogun, Suharekën dhe Vushtrrinë ndër të tjera, andaj inkurajohen vajza dhe gra nga e tërë Kosova të aplikojnë. Disa nga pozicionet e hapura përfshijnë: Zyrtare për Eficiencë të Energjisë, Hulumtuese, Asistente e Rrjetëve Sociale, Inxhinierë e Elektroteknikës,

Përmes programit “Gratë në Energji”, MFK përpiqet të ngrejë vetëdi-



jësimin e grave mbi mundësitë që sektori i energjisë ofron, si dhe njëkohësisht të përgatisë ato për tregun e punës, duke iu ofruar bursa studimore, punë praktike dhe trajnime. Të gjitha këto, do të rezultojnë me rritjen e numrit të grave të përgatitura profesionalisht për punë të ndërlidhura me energji, si dhe me zvogëlimin e hendekut gjinor në këtë sektor në Kosovë.

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK) është fondacion i pavarur i themeluar në vitin 2017 për të implementuar Marrëveshjen e Pragut midis Qeverisë së Kosovës dhe Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (Millennium Challenge Corporation-MCC), me vlerë 49 milion dollarë. Programi i Pragut i Kosovës adreson dy pengesa kryesore për rritjen ekonomike të Kosovës: furnizimin jo të qëndrueshëm me energji elektrike; dhe dobësitë reale dhe të perceptuara në sundimin e ligjit, përgjegjshmërinë e qeverisë dhe transparencën.

Presidenti i COP26 Alok Sharma: Planeti ynë po ndryshon për keq dhe ne duhet të bashkëpunojmë

Pas Romës vëmendja e liderëve botërorë ndalet në Glasgow të Skocisë, ku zhvillohet konferenca e 26-të e Kombeve të Bashkuara kushtuar ndryshimeve klimatike. Në këtë takim mori pjesë edhe kryeministri Rama.

Takimi ku mblidhen 200 delegatë ndodh në momentin kur bota është duke u përballur me kushte ekstreme të motit, përmytje ekstreme dhe zjarre.

Veproni urgjentisht është thirrja e mijëra aktivistëve të cilët janë duke marshuar në rrugët e Glasgow. Edhe Papa Françesku u bëri thirrje udhëheqësve botëror të dëgjojnë vuajtjen e Tokës.

“Miq në secilin shtet, ne dita ditës po shohim ndikimet shkatërruese të ndryshimeve klimatike. Planeti ynë po ndryshon për keq por ne duhet të bashkëpunojmë,” – u shpreh në nisje të konferencës presidenti i COP26 Alok Sharma.

Shtetet e mëdha Kina, India dhe Brazili po përballen me presion për të forcuar angazhimet e tyre.

Qëllimi global është për të ruajtur rritjen mesatare globale të temperaturës nën 2 gradë Celsius dhe për të vazhduar përpjekjet për ta kufizuar atë në 1.5 gradë Celsius.

Konferenca në Glasgow do të zgjasë deri më 12 nëntor.

Konferenca u hap nga sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres i cili tha se ‘bota po i hap varrin vetes’ duke përdorur lëndë djegëse fosile, teksa bëri thirrje për të marrë masa të menjëhershme për të shmangur katastrofat.

Guterres iu bëri thirrje pjesëmarrësve që duhet të mblidhen çdo vit për të rishikuar objektivat e tyre klimatike dhe jo një herë në 5 vjet siç e parashikon marrëveshja e Parisit për klimën. Kjo deklaratë e Guterres po nxitet nga një grup vendesh që janë më riskuar nga ndryshimet klimatike, ndërsa pritet që të ketë kundërshtime edhe nga vendet e tjera për shkelje të marrëveshjes së Parisit.

Për presidentin e SHBA-së, Joe Biden kjo është një dekadë vendimtare ku liderët botërorë duhet të tregojnë veten. Gjatë fjalës së tij, Biden tha se ndryshimet klimatike po shkatërrojnë jetët e njerëzve çdo ditë, prandaj duhet të merren angazhime konkrete, ose ndryshe gjeneratat e ardhshme do të vuajnë. Presidenti përsëriti edhe njëherë angazhimin e SHBA-së për të reduktuar me 50% emetimin e gazrave karbonike



Për presidentin e SHBA-së, Joe Biden kjo është një dekadë vendimtare ku liderët botërorë duhet të tregojnë veten. Gjatë fjalës së tij, Biden tha se ndryshimet klimatike po shkatërrojnë jetët e njerëzve çdo ditë, prandaj duhet të merren angazhime konkrete, ose ndryshe gjeneratat e ardhshme do të vuajnë. Presidenti përsëriti edhe njëherë angazhimin e SHBA-së për të reduktuar me 50% emetimin e gazrave karbonike deri në vitin 2030.



deri në vitin 2030. “Rruga që kemi përpara është shumë e qartë. A do të reagojmë, a do të bëjmë atë që është

e nevojshme, a do ta shfrytëzojmë mundësinë që kemi para vetes, apo do të shohim gjeneratat e ardhshme teksa

vuajnë. Kjo është dekada që do të përcaktojë përgjigjen. Shkenca është e qartë. Kemi vetëm një dritare të

vogël para vetes, e cila po ngushtohet, për të rritur ambiciet dhe përmbushur detyrimin”, thotë Presidenti Biden.

‘Ora është një 1 minutë para mesnate dhe ne duhet të veprimë tani’, kështu është shprehur kryeministri i vendit mikpritës së konferencës, Boris Johnson. Sipas tij, njerëzimi e ka ulur kokën me kohë para problemeve të ngrohjes globale, ndërsa ka bërë thirrje që të kalohet nga fjalët në vepra, për të gjetur zgjidhje.

“Nëse nuk e marrim seriozisht ndryshimin e klimës sot, do të jetë tepër vonë që fëmijët tanë ta bëjnë këtë nesër”, tha Johnson.

Në këtë konferencë mungojnë dy presidentë të dy vendeve që janë emetues të mëdhenj të gazrave karbonikë, presidenti kinez, Xi Jinping dhe ai rus, Vladimir Putin.

Pavarësisht faktit se presidenti kinez nuk u paraqit fizikisht në konferencë, ai i dërgoi një letër Boris Johnson ku ripohoi synimin e Kinës se emetimet e karbonit do të arrijnë kulmin në 2030 dhe që neutraliteti i CO2 të arrihet vetëm në 2060.

Një goditje për konferencën është konsideruar angazhimi i kryeministrit të Indisë, Narendra Modi, ku emetimi i karbonit zero synohet të arrihet në vitin 2070. Ky synim i Indisë është 10 vjet larg atij të Kinës dhe 20 vjet larg objektivit të vendosur nga samiti.

Por, kryeministri Modi tha se India është e vetmja që i ka arritur angazhimet e saj të vendosuar si synim në konferencën e klimës në Paris në 2015.

“Sot e gjithë bota e pranon se India është e vetmja ekonomi e madhe në botë që i ka përmbushur në letër dhe frymë angazhimet e saj në Paris,” tha ai.

Samiti për klimën pason takimin e udhëheqësve të G20-ës në Romë, ku përfaqësuesit e vendeve vendosën kufizimin e ngrohjes globale mundësisht në 1,5 gradë krahasuar me periudhën paraindustriale, por nuk u dha një datë e caktuar për këtë. Edhe në drejtim të mosmetimit të CO2-it nuk kishte dakordësi mes lidërve të G20-s. Sipas deklaratës së samitit, ky objektiv duhet të arrihet deri në mesin apo fundin e shekullit.

Aktivistët e klimës i kritikuan rezultatet e samitit si të pamjaftueshme. Edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres u tregua i pakënaqur.

Kurse kryeministri britanik, Boris Johnson sheh konferencën në Glasgow si shpresë për të arritur një zgjidhje. Sipas tij nëse dështon Glasgow, dështon e gjitha.

Banda Kombëtare Muzikore “Vatra” në këndvështrimin historiko-ushtarak

(Një libër i ri është në duart e lexuesit shqiptar: Banda Kombëtare muzikore “Vatra”, banda që shkroi histori në luftën e Vlorës më 1920-tën. Krahas armëve, tankeve, avionëve, nëndetëseve, aeroplanmbajtëseve, raketave, satelitëve, dronëve, personelin e trajnuar, strategjitë ushtarake, planeve luftarake, çdo ushtri në mbarë botën ka dhe një armë tjetër, bandat ushtarako-muzikore. Në ushtri të ndryshme në botë bandat dhe instrumentet muzikore kanë filluar mijëra vjet më parë me bateri, me instrumente nga më të larmishmet deri tek instrumentet e bronzit, për t’i dhënë ritëm e frymëzim ushtrive në lëvizje, marshime e sulme, duke nxitur shpërthimin e shpirtave guximtarë të ushtarëve që luftojnë në front, apo duke mbushur kohën e lirë, asaj që edhe sot i thonë nevoja për “muzikë në ushtri” edhe pse llojet, formacionet, instrumentet janë përsosur sikurse dhe armët. Në çdo ushtri, FA, veprimtaria muzikore ushtarake simbolizon gëzim, optimizëm, shpresë, fitore. Muzika ushtarake në të gjithë planetin ka një gjuhë ndërkombëtare, notat muzikore, stilin, marshet, himnet, pararendëse të opsionit të triumfit. I tillë ishte edhe stili muzikor i bandës muzikore të vatrës në Luftën e Vlorës, ku demonstroi fuqishëm “Vatra” dhe “Afërdita”. Historia 100 vjeçare e bandës muzikore “Vatra” vjen për lexuesin “Banda kombëtare “Vatra” – një histori unike shqiptaro-amerikane”, nga studiuesi akademik dhe muzikologu Vaso Tole, i cili ka shërbyer edhe në Forcat e Armatosura).

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Intelektualët shqiptarë kudo ku jetonin në fillim të shekullit të kaluar kishin një objektiv strategjik: indipendencën, sovranitetin dhe shtetin. Pavarësia e 1912-tës “u nis” nga Stambolli, nga zemra e Sulltanatit osman që i mbante trojet shqiptare nën pushtim drejt Durrësit, por përfundoi në Vlorë. Themeluesi i shtetit shqiptar, Ismail Qemali, u kthye në Shqipëri në krye të një asambleje kombëtare prej 83 anëtarësh nga gjithë trojet shqiptare dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë në qytetin e Vlorës më 28 nëntor 1912, krijoi një qeveri të përkohshme dhe i detyroi Fuqitë e Mëdha të mblihdeshin më 17.12.1912 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Shqiptarët e mërguar në Amerikë, Egjipt, Stamboll, Paris, Romë, Sofje, Vjenë, Bukuresht etj., ishin gjithë sy e veshë për lajmë dhe të reja nga Shqipëria. Kishte rënë sërish “ora e Motit të Madh”. Shpresat ishin ringjallur dhe misionarët e shqiptarizms kishin dalë në plan të parë. Edhe pionierët e artit muzikor nuk ngeleshin mbrapa në këtë ndërmarrje që i përkiste kombit, të ardhmes së tij. Djemtë e kulturës muzikore shqiptare në mungesë të institucioneve e kishin dhënë kontributin e tyre jashtë hapësirës administrative të katër vilajeteve. Jeta dhe muzika, formacionet muzikore, bandat lokale e deri tek bandat muzikore kombëtare kishin lindur dhe rilindur, kishin filluar regjistrimin në disqe dhe ishin në avangardë të fushave të tjera duke përqafuar modelet perëndimore. Korça, Shkodra, Elbasani dhe qytete të tjera shqiptare në fushën muzikologjike ishin me sy nga perëndimi, nga instrumentet dhe formacionet e bandave muzikore nën uniformë. Kudo fillimisht kishin lindur si frymëzuese e inkurajuese të ushtrive për fitore ose sikurse quheshin “formacione të fitores”. Në Shqipëri formacionet orkestrale, banda, mandolina, i përkasin viteve 1909-1919, për “ngritjen e moralit” të shpirtave të fikur, për krijimin e gjendjeve optimiste dhe entuziaste për festa, ceremoni zyrtare, sociale e fetare, që ndihmuan ngritjen e muzikës shqiptare në forma më të përpunuara e të kultivuara, si dhe për përmirësimin e cilësinë së jetës, rritjen e kulturës dhe shijeve artistike, argëtimin dhe qytetërimin e shoqërisë të mbetur në prapambetje nga rrethanat e pushtimit. Këngët patriotike popullore shqiptare janë ndër më të njohurat. Pas shpalljes së “Hyritit” (Kushtetuta e re e Xhonturqve) më 1908 e në vijim në Shqipëri u shënuan përpjekje të mëdha nga elita intelektuale e kulturore e vendit për jetën artistike e muzikore, për argëtimin e njerëzve, edhe rrethanat historike të pushtimit. Banda Kombëtare muzikore “Vatra” edhe pse larg atdheut ishte për shqiptarët një zjarr atdhetar i ndezur në tokën e lirisë tek djemtë shqiptarë të Amerikës, që në kohë rreziku u gjendën pranë mëmëdheut. Dashurisë për Atdheun nuk i ikën kurrë moda, si më 1920-tën ashtu edhe aktualisht pas një shekulli. “Banda Kombëtare “Vatra” u shkrua në histori dhe është prezent në çdo apel kur kombi e thërret. “Jam krah atdheut mëmë në çdo situatë thotë edhe sot pas një shekulli”, sepse elita intelektuale e emigruar shkroi, foli dhe veproi kur atdheu ishte në rrezik. Djemtë e kulturës muzikore shqiptare në Amerikë, dhe jo vetëm, në mungesë të institucioneve në Shqipëri e kishin dhënë kontributin e tyre jashtë hapësirës administrative të katër vilajeteve. Jeta dhe muzika, formacionet muzikore, bandat lokale e deri tek bandat muzikore kombëtare kishin lindur dhe rilindur, duke përqafuar modelet perëndimore. Bandat muzikore fillimisht kishin lindur si frymëzuese e inkurajuese të ushtrive për fitore dhe më tej edhe për ngritjen e moralit të luftëtarëve në luftë dhe argëtim. e tillë ishte edhe “Vatra”, që e mbledhur në histori në një libër, tingëllon si një histori suksesi ushtarako-muzikore e shqiptarëve. Dhe kjo histori



vjen në një libër, një libër që është “dokument” e histori, dije e çelës, shok e mik, ushqim e pasuri, dritare e mundësi, burim mençurie, histori për mendjen, një arkiv i imagjinatës njerëzore, prezent në të gjitha situatat në mjedisin intelektual e më gjerë. Të tillë e ka sjellë në mjedisin shqiptar bandën muzikore të Vatrës akademik Vaso Tole.

Banda Kombëtare “Vatra” lartësuese e moralit në llogoret e Luftës së Vlorës

Banda Kombëtare Muzikore “Vatra” ka historikun e saj tashmë të shkruar në një libër me burime të plota arkivore, nga një personalitet i fushës që e ka përshkruar librin si një obelisk vlerash nga themeluesi dirigjenti dhe kompozitori Thoma Nasi, e deri tek veprimtaria në dobi të atdheut. Banda Kombëtare Muzikore “Vatra” edhe pse ka kaluar 101 vite nga lufta e Vlorës, veprimtaria e saj është gdhendur në kujtesën e luftës madhore kombëtare të Vlorës, luftë ku, 120 vullnetarë shqiptarë të Amerikës, të përgatitur nga federata “Vatra” në SHBA, erdhën në Shqipëri për të luftuar për çështjen kombëtare shqiptare, duke lënë Amerikën për të ndihmuar Atdheun në rrezik edhe përmes muzikës e koncerteve të saj, që u shtrinë nga Shkodra në Gjirokastër, nga Elbasani në Korçë, në Drashovicë, në llogoret e luftës në Kaninë, Kotë, Babicë ku ishte ndezur Lufta e Vlorës. Banda Muzikore “Vatra” me këngët e saj patriotike mbajti lart moralin e luftëtarëve shqiptarë të 89 çetave të ardhura në Vlorë nga e gjithë Shqipëria, që luftonin furishëm në Tepelenë, Drashovicë, Kotë, Risili, Bunavi, Bestrovë, Llogora, përreth qytetit emblemë të Vlorës. Është mjaft domethënëse hyrja në qytetin e Vlorës ditën e fitores, më 3 shtator 1920 e bandës “Vatra” e shqiptarëve të Amerikës si dhe banda muzikore “Afërdita” e Elbasanit. Në cilën luftë të mëparshme kishin marrë pjesë dy banda muzikore dhe për më tepër direkt në frontin e luftës? Detaje, fakte, argumente, burime dokumentare rreth historisë 100-vjeçare të bandës muzikore “Vatra” i gjejmë të përmbledhura nga studiuesi akademik dhe muzikologu Vaso Tole tek studimi: “Banda kombëtare “Vatra”, një histori unike shqiptaro-amerikane”, libër që është tashmë në dorën e lexuesit në kuadër të 100-vjetorit të ardhjes së tyre në Shqipëri si dhe 100-vjetorit të Luftës kombëtare të Vlorës si dhe të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

Në tokën e lirisë, ëndrrave dhe mundësive edhe si muzikantë

Amerika përtej Atlantikut është kthyer në ëndërr dhe që prej vitit 1884 ka shkuar shqiptari i parë, i njohur Kolë Kristofori nga fshati

Katund i Korçës. Botën e Re amerikane e rrëfeu në Korçë gjashtë vjet pas kthimit. Kolë Kristofori u kthye prift në Boston më 1892, por me shtatëmbëdhjetë bashkëfshatarë, që më parë ishin kurbetçinj në Rumani e Greqi, si: Hari Take Rrapo Laska, Dhoskë Sotir Adham, Thoma Sotir Adham, Josif Sotir Adham, Sotir Lezi, Geli Goni Stevenson, At Dhosi Katundi, Dhime Pano Peterson, Fani Kosta, Thoma Kosta, Hari V. Kaçka, Argjir Peto, Fani Cico Angjel, Dhima Andrea Pano, Rrapi Fanes, Toli Dhami. Në gjithë Amerikën, më 1901 kishte rreth 200 shqiptarë, kryesisht në Xhemstoun, Boston, Nju-Jork dhe Bufalo. Pas rreth tre dekadash komuniteti shqiptar në Amerikë erdhi duke u rritur. Një ndër ta, me ëndërr muzikanti, ishte djaloshi dardhar Thoma Nasi. Por larmia e profesioneve erdhi gjithmonë e duke u rritur dhe emigrantët dalëngadalë po “gjenin veten” edhe në punë të fisnikërisë, sipërmarrjes, të intelektualizmit dhe të muzikës. Kështu Thoma Nasi një nga djemtë emigrantë në Amerikë mbledhi 35 instrumentistë dhe krijoi më 1917 Bandën Muzikore shqiptaro-amerikane “Vatra”. Veglat muzikore u blenë nga më të mirat, ashtu siç kishin blerë baballarët e gjyshërit e tyre armët më të mira, për të luftuar pushtuesit nëpër shekuj. Një shekull më vonë, bandës dhe themeluesit të saj i njihet kontributi në Luftën e Vlorës dhe në edukimin muzikor në vitin e ndezur nga luftërat, vitin 1920. Paraardhësit e muzikantëve frymorë që shërbejnë sot në ceremonialin e shtetit, paradat ushtarake dhe festat kombëtare, ishin disa emigrantë që gjashtë ditë të javës punonin fabrikave dhe fermave bujqësore amerikane, ndërsa në ditët e diela ushtroheshin me dëshirë në instrumente muzikore dhe këndonin Himnin “Betimit mbi flamur” dhe Marsejezen franceze. Por ata dinin mirë edhe vargjet e Francis Scott Key “Flamuri i Larë me Yje”, dedikuar flamurit, shkruar më 14.9.1814, që e bënë flamurin simbolin kryesore kombëtar të amerikanëve.

Kënga 200-vjeçare “Flamuri i Larë me Yje”, himn edhe për shqiptarët e Amerikës

Historia e shtetit amerikan, si një ndër shtetet më të rinj të botës edhe për Thoma Nasin u bë shtëpia e tij dhe shteti i tij i dytë. Ai sikurse gjithë shqiptarët emigrantë në Amerikë mësuan edhe historikun e këtij himni: “në mbrëmjen e 13 shtatorit 1814, britanikët bombarduan Fortesën McHenry dhe gjatë natës rojet po përpiqeshin të kuptonin nëse fortesa kishte rënë apo jo. Por kur doli dielli të nesërmen në mëngjes, pamja e flamurit amerikan duke u valëvitur mbi fortesë e nxiti poetin e avokatit Francis Scott Key, të shkruante një vjershë të cilën e titulloi “Mbrojtja e Fortesës McHenry”. Francis Scott Key ia dha këto vargje kunatit dhe mikut të tij, që ishte kapiten në fortesë gjatë betejës, duke ja dhënë si dëkë personale për t’i treguar se çfarë kish shkruar. Por miku, kapiteni dhe kunati i tij filloi të shpërndante kopje të poemës dhe shpejt ajo u shfaq në gazeta: “The Star Spangled Banner” (Flamuri i Larë me Yje). Vargëzimit poetik të rreshtave, tingujt e një kënge të vjetër britanike dhe brenda pak javësh ajo filloi të këndohej përtej Merilendit. Poema u bë himni kombëtar i Amerikës, që nuk është imazh rreth luftës por rreth flamurit, një ngjashmëri me himnin e shqiptarëve. Vargëzimi poetik rreth betejës, flamurit, fitores ka sjellë emocion në mposhtjen e kundërshtarëve. Ideja e flamurit që valëvitet mbi vendin e lirë dhe vendin e të guximshmëve është simbolika e më shumë se dy shekujve. Kënga “The Star Spangled Banner” u bë zyrtarisht himni i Shteteve të Bashkuara në vitin 1931. Për shumë amerikanë dhe ata që janë bërë të tillë dekadave, ende ka një lidhje të fortë mes flamurit dhe këngës, që sjell reagim emocional kur dëgjojnë këngën-himn. Flamuri i Stolisur me Yje, u bë himni kombëtar zyrtar në vitin 1931. Ishte flamuri amerikan që nuk u përkul në fortesë përballë rrebeshit bombardues, por që vijonte të qëndronte krenar, dhe kjo emocionon çdo shqiptaro-amerikan, që e do me zemër kombin e lirisë dhe mbështetësin e aspiratave shqiptare edhe në periudhat më të vështira dhe komplekse. Është flamuri që valëvitej mbi “Fort McHenrin”, që iu dhurua familjes së gjeneralit Xhorxh Armisted dhe kjo familje e mbajti për një kohë të gjatë dhe më pas, në vitin 1909 ia dhuroi atë Muzeut Smithsonian. Pesëmbëdhjetë yjet fillestare të flamurit sot janë bërë pesëdhjetë dhe Fort McHenri qëndron e lartësuar për të treguar këtë ngjarje, historinë dhe lindjen e himnit kombëtar amerikan, e frymëzuar nga mbrojtja heroike e Fort McHenrit, që është aktualisht një park kombëtar pranë Uashingtonit.

Thoma Gregor Nasi - patriot dhe atdhetar dhe trinomi “Komb-Flamur-Himn”

Por emigrantët e parë shqiptarë në Amerikë respektonin himnin e të dy kombeve. Himni Kombëtar i shqiptarëve është himni i flamurit,

me tekst të Asdrenit dhe kompozuar nga Ciprian Porumbescu. Të dhënat ekzakte dokumentohen në librin e akademikut Vaso Tole, por edhe të dhëna nga: Kristo Kono, Vangjo Ilo, Arian Avrazi, Gaqo Avrazi, Eno Koço, Ilir Ikonimi, Niko Kotherja etj. Thoma Nasi ishte lindur në Dardhë të Korçës, më 2.3.1892 dhe u shua më 21.12.1964 në Boston. Është mjaft i njohur si themelues, dirigjent, kompozitor, veprimtar i mërgatës shqiptare në Amerikë, pjesëmarrës në Luftën e Vlorës bashkë me bandën "Vatra". Më 1898, kur ai ishte 6 vjeç, familja e tij emigroi fillimisht në Greqi dhe më tej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 6 maj 1910 me anijen "Patris". Në Masaçusets të Shteteve të Bashkuara, fillimisht punoi në një ndërmarrjeje letre. Në moshën 26 vjeçare përfundoi konservatorin e New England-it në Boston për kompozim dhe drejtues orkestre dhe punoi si flautist jo definitiv me orkestrën simfonike të Bostonit. Më 1915 themeloi formacionin orkestral me shqiptarë të Amerikës, mandolinatën "Dodona". Në vitin 1916 organizoi korin e parë të Katedrales "Saint George", në jug të Bostonit, Masaçusets. Në shtator të vitit 1917, ai organizoi dhe themeloi bandën e parë shqiptare-amerikane "Vatra" në Worcester, Masaçusets. Thoma i bë zyrarisht qytetar amerikan më 20 shtator 1919 dhe kryen edhe shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Thoma Gregor Nasi 28 vjeçar vjen me bandën "Vatra" në Shqipëri për të mbështetur Luftën e Vlorës më 1920-ën dhe udhëton nëpër Jug në një turne koncertesh. Gjatë luftës së Vlorës lindi dhe kënga shumë e njohur "Vlora, Vlora..", me vargje të Ali Asllanit me kompozim të tij. Pas luftës së Vlorës vitet 1920-1925 i kaloi në qytetin e Korçës duke i përdorur energjitë e tij në aktivitetin muzikor, kompozoi disa këngë lirike, disa pjesë të vogla për flaut/violinë e piano, si: "Fyelli i bariut", "Bilbili", "E qarë", "Katër valle" etj. Më 1925 u largua nga qeveria e kohës për organizimin e jetës muzikore dhe sistemitin e edukimit muzikor në vend. Në këtë periudhë të jetës së tij në Korçë ishte bashkë me të shoqen Olimpia, ku ai themeloi e organizoi jetën koncertore dhe edukimin muzikor në vend. Anëtarët e Vatrës kontribuan në themelimin e Orkestrës Frymore Kombëtare të Shtetit Shqiptar, sot Orkestra Frymore Kombëtare e Forcave të Armatosura. Më 1926 u largua nga vendi dhe më 1926 u rivendos sërisht në SHBA, ku vazhdoi të punonte si dirigjent i orkestrave frymore të kishave ortodokse shqiptare në Masaçusets. Ndërkohë punonte si pedagog në konservator. Në vitet '30-të, familja e tij jetoi në Masaçusets, aty ku Thoma Nasi krijoi edhe "Shkollën e Muzikës "Nassi". Në vitin 1931, Thoma Nasi organizoi një bandë në Katham, Masaçusets dhe u bë dirigjenti i parë i saj. Nga viti 1935 dha muzikë në shkollën publike të Orleans, ku njihet edhe si themelues i Orkestrës së Filarmonisë të "Cape Cod", por ishte gjithashtu aktiv në Shoqatën e Festivaleve të New England-it. Në vitet 60-të artisti Thoma Nasi gjithë krijimtarinë e tij ia dërgoi Konservatorit të Tiranës si dhe Pallatit të Kulturës në Korçë. Ai jetoi deri më 1964 në Orleans, Masaçusets ku kishte themeluar Orkestrën e Filarmonisë. Eshtat e tij prehen në varrezat e Orleansit, pranë gruas së tij Olimbia dhe djalit Albert, që ka rënë në betejë si pjesëtar i ushtrisë amerikane, gjatë Luftës së II-të Botërore. Thoma Nasi ka ngelur në piedestalin e nderit dhe të nderimit jo vetëm për muzikologjinë shqiptare, si instrumentist, dirigjent e kompozitor, por për atdhetarinë e vlerësuar nga gjithë shqiptarët, si një ndër të parët muzikantë që e pa të realizuar në praktikë trinionin: "Komb-Flamur-Himn".

**Një libër i munguar:
“Banda kombëtare muzikore “Vatra”**

Në mjedisin akademik dhe më gjerë mungonte një monografi për Bandën muzikore “Vatra” dhe vatrën e shqiptaro-amerikanëve, për kontributin e tyre në vitet ’20-të. Një boshllëk i dukshëm që e ka plotësuar më së miri Akademia e Shkencave, e cila publikoi veprën monografike “Banda kombëtare muzikore “Vatra”, një histori unike shqiptaro-amerikane”, e cila u shoqërua edhe me CD, të akademikëve të pasionuar Vasil Tole. Monografia ka kapur një prej periudhave më të vrullshme të historisë së shqiptarëve dhe kështu që i kushtoi vëmendjen e duhur historisë së ardhjes së vullnetarëve shqiptaro-amerikanë në vitin 1920, vitin kur në Shqipëri është zhvilluar Kongresi i Lushnjës si dhe tre luftëra me rëndësi vendimtare për kombin: Lufta e Vlorës, Lufta e Koplikut dhe Lufta e Dibrës. Djemtë e ardhur nga Amerika nxitën edhe më shumë ndjenjat entuziaste besimnash dhe frymën atdhetare në popull, pas rikonfirmimit të Pavarësisë me ngritjen në këmbë të popullit për t’i marrë në duar fatet e vendit, me përpjekjet e suksesshme për rikthimin e Korçës, Shkodrës, Dibrës nën sovranitetin e shtetit shqiptar dhe me luftën kombëtare të Vlorës. Banda “Vatra” u bë pjesë e historisë së luftës së Vlorës me kurajën e saj për të inkurajuar shpirtin luftarak popullor ballë për ballë me rrezikun, me repertorin e këngëve marshe që mobilizojnë ndërgjegjen atdhetare. Banda “Vatra” dhe banda “Afërdita” u bënë dy bandat muzikore që shqiptarët nuk i kishin parë kurrë në një luftë direkte në vijën e parë në llogore si mobilizuese të formacioneve luftarake që derdhen gjakun 172 dëshmorë dhe mbi 400 të plagosur. Kënga “Vlora-Vlora”, që u krijua nga drejtuesi i kësaj bande Thoma Nasi, u mbështet në tekstin e poetit Ali Asllani, duke i dhënë identitet të fuqishëm kësaj lufte, që fillimisht analistë ushtarakë nga më të thekurit nuk besonin në fitoren e shqiptarëve ndaj 20 mijë italianëve tepër të modernizuar dhe që drejtoheshin nga dymbëdhjetë ushtarakë gjeneralë akademikë. Autori i studimit “Banda kombëtare muzikore “Vatra”, akademiku Vaso Tole ka marrë në vështrim lidhjet dhe dallimet midis bandës muzikore “Vatra” dhe shoqatës atdhetare “Vatra”,

vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve në vitin 1922. Monografia është në të njëjtën kohë edhe histori e themelimit dhe e rrugëtimit të gjatë njëqindvjeçar të bandës muzikore shtetërore, krijuar mbi bazën e bandës “Vatra”, me një vendim të posaçëm të qeverisë së Sulejman Delvinës. Botimi shoqërohet edhe me një CD, ku janë regjistruar interpretime të bandës “Vatra” dhe mbart vlera të shumanshme për specialist muzikologë, për kulturë të përgjithshme, por është edhe një monografi e dashur dhe e pritshme për t’u lexuar nga publiku i gjerë. Aparati shkencor, fotot një shekullore, faksimilet, dokumentet arkivorë, urdhra, ligje, programe, platforma, instrumente, uniforma të bandës në vite, dokumente arkivore shqiptare dhe amerikane e rrisin shkallën e besueshmërisë dhe përkushtimit ndaj të vërtetave të munguara rreth bandës kombëtare muzikore “Vatra”, që realisht shkelte në llogoret e luftës dy-tre herë në ditë sikurse shkruante Thoma Nasi, Ligjërata, 1960 (faqe 99). Nëpër gjithë kapitujt e librit gjen detaje, që kërkon edhe rilexim të librit, sepse gjeografia e librit është mjaft e gjerë, kilometrazhi i atdhetarisë nuk mund të matet sikurse nuk mund të jetë shterues një libër që ka të përfshirë qindra mijëra jetë, që vunë interesin e kombit dhe të atdheut përpara interesit personal dhe hallit që i kishte çuar deri përtej Atlantikut. Ditari i Bandës muzikore të “Vatrës” dhe vargjet e poezisë së Nolit “Jepni për nënën” (fq82) është poezi-kushtrim për të gjitha kohët, edhe për kohët moderne dhe kjo në fakt u vërtetua me batalionin “Atlantik” në Luftën e Kosovës më 1999. Libri është një homazh dhe nderim për gjithë pjesëmarrësit në luftë dhe instrumentistët që vijnë të detajuar në emra që tregojnë një pjesëz mjaft të rëndësishme të historisë së Shqipërisë.

Vlerësimi për bandën muzikore “Vatra” është më se i përligjur

Pas një përgjurmje gati një shekullore edhe institucionet shqiptare “u zgjuan”. Ato vlerësuan rreth gjysmë shekulli pas vdekjes së Thoma Nasit dhe Ministria e Mbrojtjes i ka dorëzuar trashëgimtarëve të Thomas Nasit dhe Bandës “Vatra” medaljen për “Shërbime të Shquara”, në kuadër të 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar. Vlerësimet për “Bandën muzikore “Vatra”, i përkasin para së gjithash strukturave të mbrojtjes sepse banda “Vatra” ka qenë bërthama embrionale nga ka lindur OFKFA-ja. Vlerësime të mëpastajme të saj: Me të drejtë themeluesi i bandës muzikore Vatra është vlerësuar me Dekoratën “Nderi i Kombit”, me motivacionin: “Për sakrificat e kontributin e jashtëzakonshëm dhënë me ardhjen në Shqipëri, në pjesëmarrjen e tyre në Luftën e Vlorës në vitin 1920, për rolin që luajtën në forcimin e marrëdhënieve diplomatike e kulturore mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, ndërsa Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura si e vetmja orkestër frymore profesioniste në Shqipëri, pasardhëse e bandës “Vatra”, është vlerësuar “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”, me motivacionin: “Si vijuese e traditës së madhe të muzikës



patriotike, luftarake dhe marciale kombëtare të themeluar nga Banda Kombëtare “Vatra”, për popullarizimin me shumë sukses të krijimtarisë muzikore shqiptare dhe repertorit më të njohur ndërkombëtar në Shqipëri; si orkestra e shtetit shqiptar, që me cilësi artistike dhe disiplinë ushtarake, ka zbatuar në çdo kohë me përpikëri e përkushtim Protokollin e Shtetit Shqiptar, si formacioni muzikor unik që lartëson vlerat e Himnit dhe Flamurit tonë Kombëtar përmes interpretimeve dinjitoze e solemne”. Ka qenë “Vatra”, bërthama dhe embrioni i formacionit muzikor ku lindi Orkestra Frymore e Ushtrisë Popullore, që sot janë emërtuar “Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura”. Aktivitetin e Thoma Nasit dhe bandës muzikore “Vatra”, e gjejmë në librin: “Vaso Tole, Banda kombëtare muzikore “Vatra”, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2020; Nedai Thëllimi, Artistët korçarë në sheshuj, Vasil Ballauri, Një Dritare në Historinë e Muzikës së Korçës, 1800 – 1940, Kristaq Ll. Jorgji, Tempulli, nr 1, etj.

**“Habent sua fata libelli/Librat
kanë fatin e tyre” dhe hovet e trimërisë**

Libri i akademikut Vaso Tole “Banda Kombëtare “Vatra” një histori unike shqiptaro-amerikane” është një gur i gdhendur me merak, është një copëz e historisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të XX-të. Libri është një dimension i ri kulture, historie dhe identiteti.

Një punë e jashtëzakonshme për një formacion të jashtëzakonshëm që u themelua dhe u drejtua nga Thoma Nasi më 17.12.1916. Banda që themeloi ishte një dritare e re muzikore e botës shqiptare, e konceptit të edukimit muzikor, e botimeve muzikore dhe e krijimit të Bandës presidenciale, Bandës mbretërore e më tej Bandës së Ushtrisë e 45 orkestra frymore dhe fanfara e deri tek Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura dhe bandat muzikore të bashkive. Qëllimi i saj ishte: “për t’i shërbyer çështjes kombëtare me dashuri vëllazërore” dhe se Banda nuk mund të shpërndahej në Amerikë por në Shqipëri. “Armët” e tyre ishin veglat muzikore që u blenë nga më të mirat sepse edhe gjyshërit e tyre ashtu i blinin armët. Sot nuk bëjmë vetëm një promovim libri por është edhe një ditë homazhi për themeluesin e Bandës Kombëtare “Vatra” Thoma Nasi, për familjen Nasi, për muzikantin Albert Thoma Nasi, muzikanti që u rreshtua në ushtrinë amerikane sikurse bënë edhe 3441 shqiptarë të tjerë në Amerikë. Biri i muzikantit të madh Thoma Nasi, Alberti ishte pjesë e denjë e ushtarëve amerikanë që erdhën me armatat antifashiste amerikane por ngeli përjetësisht si muzikanti dëshmor i LIIB për çlirimin e Europës. Libri është vlerë e spikatur që ndriçon, hedh dritë në kuptimin e jetës muzikore, në një ndër periudhat kur në truallin shqiptar mungonin shumë gjëra, mungonte edhe liria, për kuptimin dhe përmbushja e jetës me dimensionin e mençurisë njerëzore, bëri që Banda “Vatra” të ishte njësh me vatrën shqiptare, me hallet e kohës, të ishte një bandë muzikore e armatosur me pushkë e fishek me këngët e popullit, me ëndrra e shpresa për lirinë. Stili i thjeshtë dhe referencat e shumta e bënë librin solid, të formimit akademik e shkencor, një amanet brezash muzikorë që vjen tek lexuesi nga dora e një ustai akademik për librat. Latinët shprehen: “Habent sua fata libelli/Librat kanë fatin e tyre”, sikurse arkivat, dokumentet, dijet. Librat kanë mijëra fjalë, zgjojnë ide, ndriçojnë studime dhe kanë destinacion të sigurt. Intelektualizmi shqiptar i fushës muzikore, dhe jo vetëm, gjithmonë do të ketë uri dhe dëshirë që të lexojë të vërtetat e fillim shekullit të kaluar si dhe përpjekjet shqiptare në luftë, në diplomaci, në pavarësi, kongrese, luftëra kombëtare e lokale, do të flasë e tregojë për bandën “Vatra”, që erdhi në zjarrin e luftës për liri dhe ngeli frymëzuese brezash. Tingujt e bandës “Vatra”, frymëzuan dhe mobilizuan luftëtarët në beteja, me tingujt e saj ranë të përgjakur për lirinë e vendit, me tingujt e saj u ringritën dhe gjetën forcë e shpresë deri kur atdheu u bë i lirë. Nuk ka betejë të historisë ku janë përdorur mjetet muzikore dhe mendimin ushtarak të mos e ketë marrë në analizë e studim si një prej elementëve decizivë të fitores. Me të drejtë autori i referohet Sederholm-it (pjesëtar i grupit të Lidhjes së Kombeve që monitoronte kufirin jugor të Shqipërisë në vitet ’20-të): “... një komb që arrinte të krijonte të tilla grupe si Banda “Vatra”, dhe të donte muzikën aq sa njerëzit e shprehin këtë me vërshtimin nëpër koncerte, natyrisht që meritonte lirinë e tij”. Le t’i hedhim një vështrim ngjarjeve të 1920-tës, me një kongres dhe tre luftëra në Vlorë, në

“Strong Eagle 3” Stërvitja e përbashkët shqiptaro-britanike

